



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

PASQYRAT FINANCIARE
FONDET NË MIRËBESIM
PËR PERIUDHËN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

PËRMBAJTJA

PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE TË FONDEVE NË MIRËBESIM.....	5
GJENDJA E LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM	6
HYRJE NË SHËNIMET SHPJEGUESE.....	8
BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE	8
SUBJEKTI RAPORTUES.....	8
RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE PËRMES LLOGARIVE TË AKP-SË.....	9
VALUTA RAPORTUESE.....	9
DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE.....	9
TË HYRAT DHE PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE	10
1. TË HYRAT NGA SHITJA.....	10
2. TË HYRAT E REALIZUARA NGA QIRATË	12
3. INTERESI I FITUAR	13
4. TARIFA PËR TENDERËT E SHITJES DHE KONFISKIMET E BID DEPOZITAVE.....	14
5. BID DEPOZITAT PËR PJESËMARRJE NË TENDER.....	14
6. TË HYRAT E TJERA	15
7. KAPITALI THEMELTAR I AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	16
SHPENZIMET/SHPËRNDARJA	17
8. 20% I PUNËTORËVE TË TRANSFERUARA NË BSPK	17
9. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE (OSH)	17
10. MALLRA DHE SHËRBIME	20
10.1 PAGESAT NDAJ OFRUESVE TË SHËRBIMEVE	21
11. SHËRBIMET PUBLIKE	23
12. TATIMET	23
13. VENDIMET E GJYKATAVE/PËRMBARUESVE	24
14. TRANSFERIMI I MJETEVE 5% PËR MBULIMIN E AKTIVITETEVE TË AKP-SË	25
14.1 TË HYRAT E REALIZUARA PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT.....	25
15. SHPENZIMET TJERA	26
16. PAGESAT NDAJ KREDITORËVE TË NSH-VE NË LIKUIDIM	27
17. FONDET TEPRICË TRANSFERUAR QEVERISË SË KOSOVËS	28
LLOGARITË E ARKËTUESHME	29
18. NDËSHKIMET NDAJ NSH-VE ME SPIN-OFF SPECIAL.....	30
19. SHITJA E ASETETEVE PËRMES VALËVE TË PRIVATIZIMIT	31
20. QIRAJA APO TË HYRAT TË TJERA	32
LLOGARITË E PAGUESHME DHE DETYRIMET KONTIGJENTE.....	33
21. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE.....	33
22. MALLRA DHE SHËRBIME	33
23. OBLIGIMET NDAJ KREDITORËVE TË NSH-VE	34

24.	DETYRIMET KONTIGJENTE.....	35
PAGESAT E REALIZUARA NGA TARIFA ADMINISTRATIVE		36
TRANSFERET BRENDA LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM NË BQK DHE GJENDJA NË BANKAT KOMERCIALE		37
	TRANSFERET BRENDA LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM	37
	LLOGARITË BANKARE TË TJERA NË BANKAT KOMERCIALE	37
GJENDJA E PROCESIT TË LIKUIDIMIT TË NSH-VE NË LIKUIDIM		38
LLOJET E LLOGARIVE BANKARE		40

PASQYRAT FINANCIARE 2017

- **PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE TË FONDEVE NË MIRËBESIM**
- **GJENDJA E LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM**

PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2017

		Deri me 31 dhjetor 2016	Periudha Janar – dhjetor 2017	Deri me 31 dhjetor 2017
PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE	Shënimet shpjeguese			
Të hyrat nga shitjet	1	666,082,049	31,087,867	697,169,916
Të hyrat nga qiraja	2	26,034,444	6,528,207	32,562,651
Interesi i fituar	3	34,844,700	0.00	34,844,700
Tarifa për tenderat e shitjes dhe konfiskimet e BID depozitave	4	7,577,564	652,400	8,229,964
BID depozitat e ofertuevse	5	592,320	1,438,500	2,030,820
Të hyra të tjera	6	6,707,317	159,218	6,866,535
Kapitali themeltar i Agjencisë	7	1,013,200	0.00	1,013,200
	GJITHSEJ	742,851,594	39,866,192	782,717,786

		Deri me 31 dhjetor 2016	Periudha Janar – dhjetor 2017	Deri me 31 dhjetor 2017
PAGESAT/SHPËRNDARJA	Shënimet shpjeguese			
20% i punëtorëve transferuar në BSPK	8	109,973,567	9,283,737	119,257,304
Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoriteti i Likuidimit)	9	14,423,930	996,000	15,419,930
Mallra dhe shërbime	10	12,186,335	2,194,849	14,381,184
Shërbime publike	11	1,262,807	731,503	1,994,309
Tatimet	12	3,288,605	1,723,361	5,011,966
Taksa/depozita të Gjykatave dhe vendimet e gjykatave/përmbaruesve	13	1,774,806	33,405	1,808,211
Transferimi i mjeteve 5% për aktivitetet e AKP-së	14	32,148,000	6,100,000	38,248,000
Shpenzimet tjera	15	715,255	34,286	749,541
Pagesat ndaj kreditorëve të NSh-ve	16	15,872,028	8,105,856	23,977,884
Fondet transferuar Buxhetit të Kosovës	17	90,244,911	325,664	90,570,575
	GJITHSEJ	281,890,244	29,528,661	311,418,904

	31 dhjetor 2016	Janar – dhjetor 2017	31 dhjetor 2017
BILANCI BANKAR I PRANIMEVE DHE SHPENZIMEVE	460,961,350	10,337,531	471,298,882

GJENDJA E LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2017

LLOJET E LLOGARIVE NË BQK	JANAR DHJETOR 2017	JANAR DHJETOR 2016	JANAR DHJETOR 2015
Privatizim	8,986,889	9,682,795	9,724,189
Likuidim	432,327,446	411,464,705	427,135,393
Para të NSH-ve në mirëbesim	5,325,079	5,016,134	3,544,638
Komercializim	-	3,667,287	3,667,287
Llogaritë e parave në mirëbesim për punëtorët	15,400,400	21,121,998	25,021,170
Depozita nga tenderët e privatizimit	-	-	-
Tarifa për Dorëzimin e Tenderit në Privatizim	-	-	267,527
Depozita nga tenderët e shitjeve me Likuidim	2,039,421	602,159	10,000
Tarifa e dorëzimit të ofertave në likuidim	14,989	65,099	335,609
Depozitat e Komisionit të Rishikimit të Likuidimit	25	25	25
Kapitali themeltar i AKP-së	1,109,549	1,109,549	1,109,549
Fondi rezervë i AKP-së	-	1,000,000	1,000,000
Donator	8,463	8,463	8,463
Tarifa administrative e AKP-së	6,086,620	7,223,136	14,995,375
Depozitat Kohor	1	-	-
GJITHSEJ	471,298,882	460,961,350	486,819,225

Llojet e llogarive bankare në Bankën Qendrore të Kosovës të cilat i administron AKP-ja janë të shpalosura në fund të shënimeve shpjeguese.

SHËNIMET SHPJEGUESE

HYRJE NË SHËNIMET SHPJEGUESE

BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik. Në përputhje me SNKSP, këto pasqyra janë prezantuar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Gjithashtu, këto pasqyra financiare i përmbushin obligimet raportuese që dalin nga “Rregullorja e Kornizës Raportuese të Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim” e aprovuar nga Bordi i Drejtorëve më 23 Shkurt 2011.

Meqenëse pasqyrat financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë përgatitur në pajtim me SNKSP, atëherë sa i përket **llogarive të arkëtueshme, llogaritë e pagueshme dhe detyrimet kontingjente janë paraqitur vetëm si shpalosje në pasqyrat financiare të Fondeve në Mirëbesim.**

Të gjitha të dhënat financiare të pranimeve dhe pagesave që janë paraqitur në këto shënime janë nga llogaritë bankare të NSh-ve që Agjencia menaxhon dhe administron në **Bankën Qendrore të Kosovës**. Të dhënat nuk paraqesin rezultate të NSh-ve që kanë pasur apo aktualisht kanë menaxhmentin aktiv, të cilët kanë menaxhuar apo administruar me llogaritë bankare në bankat komerciale.

AKP ka në dispozicion edhe shtojcat e pasqyrave financiare të Fondeve në Mirëbesim, të cilat janë raporte të detalizuara që paraqesin bilancet përfundimtare dhe trasakcionet e ndodhura gjatë periudhës raportuese. Këto raporte paraqesin detajet e kategorizuara sipas planit kontabël të fondeve në mirëbesim për llogaritë bankare që administrohen nga AKP. Shtojca e pasqyrave financiare i dorëzohen Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, Menaxhmentit dhe Departamenteve/Njësive të AKP-së.

SUBJEKTI RAPORTUES

Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji Nr. 03/L-067) që ka hyrë në fuqi me 1 Korrik 2008 e ndryshuar me Ligjin nr.04/L-034 që ka hyrë në fuqi më 21 Shtator 2011 (këtej e tutje “Ligji”) dhe ndryshimet në Ligjin me nr. 080 të datës 24 Dhjetor 2015.

Në pajtim me Ligjin mbi themelimin e AKP-së, aktiviteti i AKP-së është privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) nëpërmjet metodave të “spin off-it”, qiradhënies afatgjate, administrimi, ristrukturimi dhe likuidimi i Ndërmarrjeve Shoqërore sipas Ligjit.

Agjencia Kosovare e Privatizimit menaxhon Ndërmarrjet Shoqërore në Kosovë dhe i mban këto Ndërmarrje në Mirëbesim. AKP është e ngarkuar me "ruajtjen dhe rritjen" e vlerës së NSH-ve dhe aseteve të tyre brenda dhe jashtë Kosovës.

Periudha raportuese për pasqyrat financiare është prej 1 janar deri më 31 dhjetor 2017. Në këto pasqyra financiare janë paraqitur edhe raporte që paraqesin të dhënat financiare nga data **1 korrik 2003 deri më 31 dhjetor 2017.**

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve takohet në baza të rregullta mujore në mënyrë që t'i kryej funksionet dhe përgjegjësitë e tij sipas Ligjit.

Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendor sipas nenit 12 Të Ligjit nr. 04/L-034 të AKP-së.

Bordi i Drejtorëve emërohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Mandati i gjashtë anëtarëve të Bordit të Drejtorëve ka përfunduar në muajin dhjetor 2017, në përjashtim të Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve, mandati i të cilëve skadon në muajin dhjetor 2018.

Agjencia Kosovare e Privatizimit, në baza vjetore i raporton Kuvendit të Republikës të Kosovës sipas formatit të raportimit për Agjencitë e Pavarura.

RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE PËRMES LLOGARIVE TË AKP-SË

AKP-ja menaxhon dhe i kontrollon shpenzimet dhe të hyrat përmes llogarive në mirëbesim të hapura në Bankën Qendrore të Kosovës. AKP-ja bën transferin e pagesave pasi të jetë bërë autorizimi i urdhër-transfereve bankare sipas Procedurave Bankare të AKP-së të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve.

VALUTA RAPORTUESE

Valuta raportuese është Euro (€). Të gjitha vlerat në pasqyrat financiare janë paraqitur në vlera aktuale e jo në mijëra ('000), përveç nëse është cekur ndryshe në raportin përkatës.

DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare të fondeve në mirëbesim janë autorizuar për lëshim më datën **29 Janar 2018** nga: Ekrem Hajdari, Drejtor Menaxhues dhe Adem Selishta, u.d. Drejtor i Financave dhe Buxhetit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

TË HYRAT DHE PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE

1. TË HYRAT NGA SHITJA

Të hyrat e realizuara nga shitja paraqesin bilancet përfundimtare të pagesave deri më **31 dhjetor 2017** të hyrjeve dhe daljeve në llogaritë bankare të Ndërmarrjeve Shoqërore (fondet në mirëbesim) të cilat administrohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Pasqyra e Pranimeve për shitjet paraqet gjendjen bankare më 31 Dhjetor 2016, gjendje e transaksioneve Hyrëse/Dalëse gjatë periudhës 1 janar – 31 dhjetor 2017 dhe gjendjen përfundimtare bankare më 31 dhjetor 2017.

Tabela e mëposhtme paraqet bilancin e pranimeve për periudhën raportuese sipas llojeve të shitjeve:

LLOJET E SHITJEVE	VLERA
Shitjet Përmes Valëve të Privatizimit dhe Likuidimit	31,050,073
Të hyra nga bartja e së drejtës banesore	37,794
GJITHSEJ	31,087,867

Ashtu siç është paraqitur më lartë, shuma totale prej EUR **31,050,073** e shitjeve përmes valëve të privatizimit dhe likuidimit paraqet bilancin e pranimeve të realizuar **nga blerësit (kontrata të nënshkruara) dhe ofertuesit (të kontratave të panënshkruara)**. Pra, ky bilanc nuk paraqet realizimin e shitjeve. **Realizimit i shitjeve** ka të bëjë vetëm me nënshkrimin e kontratave me blerësit. Gjatë kësaj periudhe, shitjet e realizuara janë gjithsej **EUR 26,851,569 të gjithsej 211 kontratave të nënshkruara**. Detajet e tjera janë të paraqitura në raportin e akviteteteve të AKP-së.

PËRSHKRIMI	VLERA	RENDITJA
Pagesat e realizuara në periudhat paraprake për kontratat e nënshkruara 2017	240,298	1
Bilancet e pagesave të realizuara gjatë vitit 2017	26,608,271	2
BID depozitat të pa transferuar të kontratave të nënshkruara	3,000	3
Gjithsej pagesat e realizuara për kontratat që janë nënshkruar në vitin 2017	26,851,569	4=Σ(1:3)
Pagesa të realizuara të shitjeve të kontratave të panënshkruara/në process	4,441,802	5
GJITHSEJ BILANCI I HYRJEVE NGA SHITJA JANAR – DHJETOR 2017	31,050,073	6=4+5-1-3

Për asetin e NSh Fapol në valën 32 të shitjes ka masë të përkohshme nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës. Pala ka realizuar pagesën prej EUR 555,000 (depozitin dhe diferencën e çmimit të shitjesë). Deri në vendimin e DhPGjKS, kjo shitje mbetet pezull.

SHITJET PËRMES VALËVE TË PRIVATIZIMIT janë shitjet e realizuara të Ndërmarrjeve të Reja të themeluara nga asetet e Ndërmarrjeve Shoqërore. Me shitjen e këtyre Ndërmarrjeve të Reja transferohen edhe një pjesë e obligimeve tek blerësit si p.sh. obligimet e shërbimeve publike, tatimore apo obligime të tjera komunale.

AKP për vitin raportues, nuk ka përdorur këtë metodologji të “Shitjeve të Ndërmarrjeve të Reja”, pasi që shumica e NSh-ve kanë hyrë në likuidim, asetet e të cilave shiten **përmes procesit të likuidimit**.

Për periudhën raportuese, pagesat që janë pranuar për Shitjet e Ndërmarrjeve të Reja kanë të bëjnë me kontestet gjyqësore që AKP-ja ka fituar, që në këtë rast është lirimi nga masa e përkohshme e Dhomës të Posaçmet të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Nga masa e përkohshme **është liruar shitja e Ndërmarrjes së Re “Jugobanka Zyra në Skenderaj”** e realizuar në valën 57 të privatizimit për të cilën kemi pranuar shumën prej EUR 24,000.00. Kjo ka qenë e pasqyruar në llogaritë e arkëtueshme. *Shih llogaritë e arkëtueshme në shënimin shpjegues nr. 19*

Gjithashtu, është nënshkruar kontrata e shitjes si rezultat i heqjes të masës të përkohshme nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për shitjen e valës 42 të Ndërmarrjes së Re “AC Shtime Zyra Administrative” në vlerën prej EUR 177,898 (duke zbrituar prej EUR 1,250 kapitalin themeltar në vitin 2017). **Pagesat e kësaj shitje kanë qenë të realizuara në periudhat paraprake.**

TË HYRA NGA BARTJA E SË DREJTËS BANESORE janë pagesat nga bartja e të drejtës banesore të Ndërmarrjeve Shoqërore. Këto pagesa realizohen në përputhje me Ligjin nr. 04/L-061 për Shitjen e Banesave.

2. TË HYRAT E REALIZUARA NGA QIRATË

AKP-ja aplikon dy mënyra të dhënies me qira të aseteve: qiratë e zakonshme (NSh-të në tranzicion dhe likuidim) si dhe qiratë e komercializimit gjatë periudhës të tranzicionit të NSh-ve.

2.1. QIRATË E KOMERCIALIZIMIT

Në këtë pozicion janë të paraqitura bilancet e pranimeve për kontratat e komercializimit të nënshkruara gjatë vitit 2000 nga UNMIK. Vlera e tërësishme e inkasimeve, nga viti 2003 deri në datën raportuese është **EUR 5,021,319**.

2.2. QIRATË E NSh-VE NË TRANZITION DHE LIKUIDIM

Paraqesin bilancet e pranimeve nga qiramarrësit në llogaritë bankare të NSh-ve përkatëse, llogari të cilat AKP-ja i menaxhon dhe administron. Në përgjithësi, dhënia e aseteve me qira për këto NSh janë: lokalet, toka bujqësore, pikat e shitjes të derivateve, depot dhe të tjera.

Inkasimet e qirasë nga **viti 2003 deri më 31 dhjetor 2017** janë si më poshtë:

PËRSHKRIMI	VLERA
Qiratë e Komercializimit	5,021,319
Qiratë në llogaritë e NSh-ve në tranzicion	11,903,697
Qiratë në llogaritë e NSh-ve në likuidim	15,637,635
GJITHSEJ	32,562,651

Ndërsa sa i përket inkasimit të qirave për periudhën raportuese, të dhënat përmblledhëse janë si më poshtë:

	JANAR DHJETOR 2017	JANAR DHJETOR 2016	JANAR DHJETOR 2015
PËRSHKRIMI			
Qiratë e Komercializimit	0.00	00.00	0.00
Qiratë në llogaritë e NSh-ve në tranzicion	1,265,776	910,718	1,895,712
Qiratë në llogaritë e NSh-ve në likuidim	<u>5,262,431</u>	<u>5,226,852</u>	<u>2,900,829</u>
GJITHSEJ	6,528,207	6,137,570	4,796,541

Sa i përket të hyrave nga **komercializimi**, gjatë periudhës raportuese nuk kemi pasur inkasime të qirave, sepse këto asete të NSh-ve ose janë shitur ose janë në proces të likuidimit.

Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur inkasimet e qirave për NSh-të që kanë vazhduar aktivitetet edhe pas hyrjes në likuidim si dhe NSh-të në tranzicion që kanë nivel të lartë të inkasimeve në periudhën raportuese.

NDËRMARRJET SHOQËRORE NË LIKUIDIM

Përshkrimi	JANAR – DHJETOR			TËRË PROCESI
	2017	2016	2015	2003 – 2017
*Grand Hoteli	425,509	431,617	381,009	1,238,135
*Pallati i Rinisë, Kulturës dhe Sporteve	1,572,808	1,039,325	0.00	2,612,135
Tregu – Prishtinë	845,568	651,978	573,466	2,124,070
ABC Genci	178,922	116,364	107,748	403,034
NSh tjera në likuidim	2,239,624	2,987,568	1,838,606	9,260,261
GJITHSEJ	5,262,431	5,226,852	2,900,829	15,637,635

*NSh Grand Hoteli ka hyrë në likuidim në Shkurt të vitit 2015, ndërsa NSh Pallati ka hyrë në likuidim në Prill 2016.

Gjithashtu duhet të theksohet se, sipas informacioneve që disponojmë, të hyrat e qirasë për NSh Grand prej EUR 2,460 dhe për NSh “Mekanizimi” prej EUR 24,309 janë konfiskuar nga ATK-ja. Të hyrat kanë qenë nga dhënia me qira e shfrytëzimit të aseteve nga institucionet e Kosovës. Për më tepër shih edhe në shënimin nr. 16.

NDËRMARRJET SHOQËRORE NË TRANZICION

Përshkrimi	JANAR – DHJETOR			TËRË PROCESI
	2017	2016	2015	2003 – 2017
NSh Jugopetrol	457,121	355,559	328,309	1,188,749
Pallati i Rinisë, Kulturës dhe Sporteve	0.00	9,909	496,908	1,377,372
NSh Treska	22,510	15,050	0.00	37,560
NSh Ina Trgovina	656,957	482,527	1,032,743	2,780,338
Invest Banka	51,522	0.00	0.00	51,954
Radio Televizioni i Prishtinës	62,771	0.00	0.00	85,577
NSh tjera në tranzicion	14,895	47,673	37,752	6,382,147
GJITHSEJ	1,265,776	910,718	1,895,712	11,903,697

3. INTERESI I FITUAR

Të hyrat nga interesi janë:

- interesi i fituar nga llogaritë rrjedhëse në Bankën Qendrore të Kosovës. Për informatën e juaj, nga Korrik 2012, norma e aplikuar e interesit nga BQK është **zero %**;
- interesi bankar i fituar nga afatizimi për periudhat nga 1 muaj deri në 12 muaj i një pjese të mjeteve nga llogaritë bankare të fondeve në mirëbesim. Nga Korriku i vitit 2015 nuk ka të hyra nga interesi.

Gjithsej interesi i përgjithshëm i fituar nga viti 2003 deri në datën raportuese është **EUR 34,844,700** në të gjitha llogaritë bankare të hapura në BQK. **Për vitin fiskal 2017, nuk ka pasur të hyra nga interesi për shkak të normave të cilat nuk janë pozitive.**

Me Projekt-Ligj për ndryshimet dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, është paraparë që fondet tepricë, fondet e mbetura dhe fondet e përkohshme, të gjitha të ardhurat e mbledhura nga Agjencia si rezultat i aktiviteteve të saj sipas këtij Ligji dhe të cilat mbahen në mirëbesim mund të investohen në instrumentet në vijim:

- Llogari rrjedhëse që paguan interes apo depozitë të afatizuar në Bankën Qendrore të Kosovës; dhe
- Letra me vlerë të borxhit të emetuara nga ndonjë autoritet publik i Republikës së Kosovës ose të garantuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

4. TARIFA PËR TENDERËT E SHITJES DHE KONFISKIMET E BID DEPOZITAVE

Janë të hyra të realizuara për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Në përgjithësi, këto të hyra përfshijnë llogaritë bankare në të cilat janë gjeneruar të hyra nga **tarifat për paraqitjen e tenderëve dhe konfiskimin e BID depozitave të ofertuesve** të cilët nuk i kanë përmbushur kushtet e pagesës. Llogaritë bankare janë si më poshtë:

- Tarifa për dorëzimin e ofertave të privatizimit;
- Tarifa për dorëzimin e ofertave të likuidimit; dhe
- Fondi Rezervë i AKP-së

Shuma prej EUR 7,577,564 paraqet gjendjen e transaksioneve bankare nga viti 2003 deri më 31 Dhjetor 2016. Ndërsa, **bilancet prej EUR 652,400** për periudhën janar – dhjetor 2017 janë paraqitur sipas tabelës të mëposhtme:

PËRSHKRIMI		VLERA
Bilanci bankar i llogarive për pjesëmarrje të tenderëve deri më 31 Dhjetor 2016		7,577,564
Tarifa për pjesëmarrje në tender 2017	+	498,300
Kthimin e tarifës administrative/anulim tenderi apo raste tjera 2017	-	(8,400)
Konfiskimin e BID depozitave të ofertuesve që nuk kanë plotësuar kushtet	+	162,500
GJENDJA DERI MË 31 DHJETOR 2017	=	8,229,964

Gjithashtu vlen të përmendet se shuma e BID depozitit prej EUR 44,000 e konfiskuar gjatë vitit fiskal 2017 do të kthehen ndaj ofertuesit. Pra me kthim të mjeteve ndaj ofertuesit, kjo shumë do të zbritet nga e hyra e vitit 2017 në fillim të vitit 2018. Kthimi i BID depozitit për këtë rast është në përputhje me procedurat e tenderit nëpërmjet të cilës, pala ka ofruar dokumente mbështetëse dhe në menyrë të plotë ka arsyetuar shkakun e tërheqjes nga tenderi.

5. BID DEPOZITAT PËR PJESËMARRJE NË TENDER

Mbanë BID depozitat e ofertuesve që kanë marrë pjesë në tender dhe për të cilët ende nuk ka përfunduar procesi i shitjes. Me përfundim të procesit të shitjes, bilanci bankar do të jetë zero, sepse me nënshkrimin e kontratave, këto BID depozita, si pjesë e vlerës së blerjes, transferohen në llogari të NSh-ve përkatëse për të cilat janë shitur asetet dhe lidhur kontratat.

Janë dy lloje të llogarive bankare që kanë të bëjnë me këtë proces:

- Llogaritë e BID depozitave të ofertës të privatizimit;

- Llogaritë e BID depozitave të ofertës të likuidimit;

Shuma prej **EUR 592,320** paraqet gjendjen e transaksioneve bankare nga viti 2003 deri më 31 Dhjetor 2016.

Ndërsa, **bilancet prej EUR 1,438,500** për periudhën janar – dhjetor 2017 janë paraqitur sipas tabelës të mëposhtme:

PËRSHKRIMI	VLERA
Bilanci bankar i llogarive për pjesëmarrje të tenderëve deri më 31 Dhjetor 2016	592,320
BID Depozitat e paguara nga ofertuesit për pjesëmarrje në tender	+ 28,304,481
Kthimi i BID Depozitave ndaj Ofertuesve të pasukseshëm	- (23,466,374)
Bartje e BID depozitave pas nënshkrimit të kontratave në llogaritë e NSh-ve	- (3,237,107)
Konfiskimin e BID depozitave të ofertuesve të pasukseshëm (<i>shënimi nr. 4</i>)	- (162,500)
GJENDJA DERI MË 31 DHJETOR 2017	= 2,030,820

6. TË HYRAT E TJERA

Janë të hyrat të cilat janë realizuar në llogaritë e NSh-ve në tranzicion, NSh-ve në likuidim, Donatorëve dhe të tjerë në vlerën prej **EUR 6,866,535**. **Kjo vlerë paraqet inkasimin e mjeteve nga viti 2003 – dhjetor 2017.**

Nga viti 2003, këto të hyra janë si më poshtë:

- Shitja e mallrave dhe shërbimeve;
- Dividenta dhe shitja e aksioneve;
- Transferimi i mjeteve nga llogaritë bankare të NSh-ve të cilat kanë qenë aktive në bankat komerciale
- NSh-të e paraqitur si kreditor për pretendimet e saj (Debitorët e NSh-ve)

Për periudhën raportuese mjetet pranuar prej **EUR 159,218** janë si më poshtë:

PËRSHKRIMI	VLERA
Bilanci bankar i të hyrave të tjera më 31 Dhjetor 2016	6,707,317
Nga marrëveshja ndërmjet “MIM Golesh” dhe “Bectel”	+ 55,657
Inkasimet ditore në para të gatshme nga aktiviteti për NSh Tregu	+ 13,244
Inkasimet ditore në para të gatshme për NSh ABC Genci	+ 39,286
Inkasimet ditore në para të gatshme për NSh Grand Hotel	+ 33,200
Pranimet nga debitorët e NSh-ve	+ 14,374
Të hyra të tjera në llogaritë e NSh-ve	+ 3,172
Transferimi i mjeteve nga llogaritë në bankat komerciale	285
GJENDJA DERI MË 31 DHJETOR 2017	= 6,866,535

Inkasimet ditore në para të gatshme në të mirë të llogarive të NSh-ve përkatëse kanë të bëjnë me mjetet që pranohen gjatë aktivitetit ditor për të hyrat si: bifet, shitja e biletave, shërbimeve apo të tjera tek NSh të tilla si ABC Genci, NSh Grand Hotel si dhe NSh Tregu. Këto NSh janë në likuidim, llogaritë e të cilave i menaxhon dhe administron AKP.

7. KAPITALI THEMELTAR I AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Në përputhje me nenin 17 të Ligjit nr. 04/L-034, Agjencia ka hapur llogarinë bankare për kapitalin themeltar. Gjithsej vlera e kapitalit themeltar është EUR 10 milion, ndërsa shuma e transferuar nga Qeveria është EUR 1 milion. Pjesa e mbetur prej EUR 9 milion mund të kërkohej nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së në kohën dhe në shumën e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë.

Më poshtë janë të paraqitura detajet e kapitalit themeltar për të gjitha transaksionet nga viti 2003 deri në **datën raportuese**:

- **Të hyrat në llogarinë e kapitalit prej EUR 1,132,172**
 - Të hyra nga pagesa e kapitalit themeltar prej EUR 1,013,200. Pagesa është realizuar nga Qeveria e Kosovës;
 - Të hyrat nga interesi prej EUR 118,972. *Janë pjesë përbërëse e shënimit shpjegues nr. 3.*
- **Pagesat nga llogaria e kapitalit prej EUR 22,623**
 - Pagesat e vendimeve të Gjykatave prej EUR 22,616. *Janë pjesë përbërëse e shënimit shpjegues nr. 13.*
 - Shpenzimet bankare prej EUR 7.00. *Janë pjesë përbërëse e shënimit shpjegues nr. 15*
- **Gjendja bankare në fund të periudhës 1,109,549**

Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur asnjë transaksion në llogarinë e kapitalit themeltar.

SHPENZIMET/SHPËRNDARJA

8. 20% I PUNËTORËVE TË TRANSFERUARA NË BSPK

Nga viti 2003 deri në periudhën raportuese shuma e transferuar e 20% të shitjes për punëtorët e NSh-ve në llogarinë e BSPK-së është **EUR 119,257,304** nga 305 Ndërmarrje Shoqërore.

Ndërsa vetëm për periudhën raportuese, gjithsej bilanci i pagesave në të mirë të llogarisë bankare të BSPK-së është **EUR 9,283,737** dhe atë (pagesa dhe kthim të mjeteve) në llogaritë bankare të 73 Ndërmarrjeve Shoqërore. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur pagesat sipas llojit të llogarive bankare:

PËRSHKRIMI	VLERA
Llogaritë e Privatizimit - Shitjet e Ndërmarrjeve të Reja	325,823
Llogaritë e Likuidimit - Shitjet e aseteve përmes procesit të likuidimit	2,814,843
Llogaritë e Tranzicionit	0.00
Llogaritë në mirëbesim për punëtorët e NSh-ve	6,143,071
GJITHSEJ PAGESAT 1 JANAR - 31 DHJETOR 2017	9,283,737

Agjencia Kosovare e Privatizimit, mjetet e 20% të punëtorëve i transferon në llogarinë bankare të BSPK-së.

BSPK-ja pastaj bënë shpërndarjen sipas listës të aprovuar të 20% të punëtorëve. Për rastet që ka ankesa, mbahen në llogari të fondeve në mirëbesim të cila i administron AKP-ja.

Gjendja bankare që mbahet në mirëbesim deri në zgjidhjen e këtyre kontestet gjyqësore është EUR 15,400,400

Për periudhën raportuese, numri i punëtorëve që kanë përfituar nga 20%-it është 10,231. Numri i përgjithshëm i punëtorëve që kanë përfituar nga shpërndarja e 20% për periudhën 2003 – 2017 është 47,256.

9. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE (OSHP)

Më 11 korrik 2012 është kontraktuar kompania për Ofruesin e Shërbimeve Profesionale mes AKP-së dhe “Deloitte Central Europe Limited” si pjesë e Autoritetit të Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Sipas kontratës bazë janë dy lloje të pagesave: fikse (kuartale) dhe variabile. Vlera e tërësishme e pagesave sipas kontratës bazë është **EUR 14,008,930**.

Aneks kontrata me “Deloitte Central Europe Limited” dhe AKP-në është lidhur me 8 gusht 2016. Deri më tani janë realizuar pagesa në vlerën prej **EUR 1,411,000**.

Tabela e mëposhtme paraqet vlerat e kontraktuara të kontratës bazë dhe aneks kontratës si dhe të gjitha pagesat e realizuara nga viti 2012 deri më 31 dhjetor 2017.

PËRSHKRIMI	KONTRATA	PAGESAT	TEPRICAT	%
*Kontrata e parë bazë - kostoja fikse	4,924,740	4,924,740	0.00	100
*Kontrata e parë bazë - kostoja variabile	13,003,564	9,084,190	3,919,374	69.86
Aneks kontrata 10% e vlerës të kontratës bazë	1,992,000	1,411,000	581,000	70.83
GJITHSEJ	19,920,304	15,419,930	4,500,374	75.74

* vlera e kontraktuar në tabelë përfshin edhe TVSh-në prej 16%. Norma e TVSh-së pas periudhës 1 Shtator 2015 është 18%. Tepricat tek kontrata bazë nuk janë obligime, por është vetëm pasqyrim i gjendjes të pagesave kundrejt vlerës të kontraktuar.

Ndërsa sa i përket për periudhën raportuese, **pagesat e realizuara janë EUR 996,000**. Më poshtë janë paraqitur pagesat ndër-vite:

VITET	KONTRATA BAZË		ANEKS KONTRATA	GJITHSEJ
	FIKSE	VARIABLE	FIKSE	
2012	1,228,009	0.00	0.00	1,228,009
2013	1,228,009.00	2,781,117	0.00	4,009,126
2014	491,204	3,277,988	0.00	3,769,192
2015	245,602	1,458,973	0.00	1,704,575
2016	1,731,916	1,566,112	415,000.00	3,713,028
2017	0.00	0.00	996,000.00	996,000
GJITHSEJ	4,924,740	9,084,190	1,411,000	15,419,930

KONTRATA BAZË Gjithsej vlera e kontraktuar me Ofruesin e Shërbimeve “Deloitte” sipas nr. të kontratës 239/11/068/211 ka qenë në shumën prej EUR 19,920,304. Kontrata ka përfunduar më datën **9 Korrik 2016**. Sipas kontratës në fjalë, kanë qenë dy lloje të pagesave:

1. KOSTOJA FIKSE

Vlera e kontratës në shumën prej EUR 4,912,036 e ndryshuar pastaj me normën e TVSh-së me 18% në 4,924,740 (ndryshimi vetëm prej EUR 12,704). Pagesa është realizuar pas aprovimit të raportit nga Komisionin e Bordit për aprovimin e raporteve të kontraktorit;

2. KOSTOJA VARIABLE

Vlera e kontratës në shumën prej EUR 13,003,564. Sipas kontratës, përveç pagesave të kostos fikse, gjithashtu kanë qenë edhe pagesat për secilin kërkesë të kreditorit të shqyrtuar (vendim/refuzim). Kanë qenë katër lloje të kërkesave të kreditorëve të cilët janë kategorizuar sipas kontratës. Secili vendim ka pasur shumën e kontraktuar të cilat janë:

- EUR 299.00 për pronësinë e aseteve specifike dhe kërkesat e pronarëve – aksionarëve;
- EUR 99.00 për kreditorët e pasiguruar, pagat e papaguara dhe tri pagat e punëtorëve.

ANEKS KONTRATA 10% E VLERËS TË KONTRATËS BAZË

Më datën 8 Gusht 2016 është nënshkruar kontrata e re si aneks i kontratës bazë në vlerën prej 10%. Vlera totale e kontraktuar është EUR 1,992,000. Sipas aneks kontratës, në periudha mujore realizohen pagesat prej EUR 83,000 për 24 periudha.

GARANIONI BANKAR Agjencia Kosovare e Privatizimit ka pranuar një garancion bankar lidhur me performancën e aneks të kontratës nga Deloitte Central Europe Limited për Ofrimin e Shërbimeve Profesionale për likuidimin e portfolios së NSH-ve (nr. i prokurimit 239-11-068-211). Detajet e garancionit bankar janë si vijon: data e garancionit 21 Shtator 2016, shuma e garancionit 199,200.00, emri i bankës që ka lëshuar garancionin: ING Bank N.V. PO BOx 350, 1000 Amsterdam, The Netherlands.

Shënim lidhur me pagesat e Ofruesit të Shërbimeve Profesionale (OSHP):

Në kërkesën buxhetore për vitin 2017 të cilën e kemi dërguar në Ministrinë e Financave (MF) me 12 Tetor 2016, kemi kërkuar nga buxheti i Kosovës (Granti Qeveritar) buxhetin shtesë mbi kufijtë buxhetorë në programin e Likuidimit (kodi 227) për mbulimin e shpenzimeve të procesit të likuidimit për të gjitha ndërmarrjet shoqërore në Republikën e Kosovës. Gjithsej shuma e kërkesës buxhetore për vitin 2017 ka qenë EUR 996,000. Kërkesat buxhetore në MF për të mbuluar shpenzimeve e procesit të likuidimit për OSHP kanë qenë për çdo vit fiskal nga viti 2013.

Pavarësisht kërkesës së AKP-së dhe sqarimet në dëgjimet buxhetore, edhe këtë vit, Ministria e Financave nuk ka aprovuar kërkesën buxhetore.

Pasi që nuk janë ndarë mjetet nga Buxheti i Kosovës, deri më tani pagesat janë bërë sipas rezolutës së Bordit të Drejtorëve të datës 21 Qershor 2012. Më këtë rezolutë, financimi i kostove të likuidimit (nenet 40.1.1.1 dhe 40.1.1.3 të Shtojcës së Ligjit të Agjencisë) bëhet si në vijim:

- a) Tarifa fikse e Autoritetit të Likuidimit paguhet përkohësisht nga llogaria bankare e tarifës administrative të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në momentin e caktimit të saktë të kostos fikse proporcionalisht për secilën ndërmarrje shoqërore në likuidim, atëherë llogaria e tarifës administrative të Agjencisë kompensohet nga llogaria bankare e ndërmarrjes në likuidim;*
- b) Tarifa variabile (për kërkesat e shqyrtuara) e Autoritetit të Likuidimit dhe kostot tjera të paraqitura në kostot 1.1 dhe 1.3 të nenit 40.1 të shtojcës së ligjit nr. 04/L-034 paguhen nga fondet e ndërmarrjes në likuidim. Në rast se ende nuk ka fonde të mjaftueshme në llogarinë bankare të likuidimit, atëherë tarifa variabile paguhet përkohësisht nga llogaria bankare e tarifës administrative të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në momentin që do të ketë fonde të mjaftueshme në llogarinë e likuidimit, atëherë llogaria e tarifës administrative të Agjencisë kompensohet nga llogaria e ndërmarrjes në likuidim.*

10. MALLRA DHE SHËRBIME

Në përgjithësi në këtë kategori përfshihen pagesat për: ofruesve e shërbimeve për NSh në Likuidim dhe Pagat e Punëtorëve – NSh në tranzicion; qiraja; shpenzime për reklamim; shërbime profesionale dhe mirëmbajtja dhe ruajtja e aseteve.

Nga viti 2003 deri në datën raportuese gjithsej pagesat e realizuara për mallra dhe shërbime janë në vlerën prej **EUR 14,381,184**.

Ndërsa vetëm për periudhën raportuese, vlera e tërësishme e bilancit të pagesave është prej **EUR 2,194,849** dhe atë:

PËRSHKRIMI	VLERA
Pagesat e realizuara ndaj palëve të jashtme	2,209,017
Kompenzimi nga NSh në llogarinë e tarifës administrative	- (14,168)
GJITHSEJ	= 2,194,849

Kompenzimi i llogarisë të tarifës administrative ka efektin zero të shpenzimeve të përgjithshme të fondeve në mirëbesim. Shuma prej EUR 14,168 paraqitet si zbritje (minus) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ndërsa në anën tjetër është paraqitur si shpenzim (plus) në kategorinë e shërbimeve publike, taksave gjyqësore etj. Këto shpenzime kanë ndodhur më parë nga llogaria e tarifës administrative të AKP-së për shpenzimet e NSh-ve përkatëse dhe pastaj kjo llogari kompensohet nga llogaritë e NSh-ve në likuidim.

Ndërsa sa i përket pagesave të realizuara nga fondet në mirëbesim ndaj palëve të jashtme, ato janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Këto pagesa janë realizuar nga llogaritë e NSh-ve në tranzicion, likuidim dhe tarifa administrative e Agjencisë.

LLOJET E PAGESAVE	VLERA
Ofruesit e Shërbimeve dhe pagat e punëtorëve (MIM Golesh) – <i>shih shënimin 10.1</i>	1,800,574
Shërbime për mirëmbajtje dhe ruajtje të aseteve me operatorët ekonomik	16,784
Shërbime profesionale Angazhimi i përmbauesve/përfaqësime ligjore dhe ekspertizë ligjore	35,062
Qiraja e paguar për NSh Tregu	36,000
Furnizim me material higjienik, administrative dhe bifesë për Grandin, Pallatin dhe ABC Genci	43,397
Pagesat për marrëveshjet e kontraktuara të filmave për ABC Genci në likuidim	18,783
Ngruhje qendrore për NSh Grand Hotel dhe Pallati në likuidim	122,726
Shpenzime të marketingut, përkthime, auditime, taksa gjyqësore dhe tjera	13,945
Shpallje në gazeta vendore dhe ndërkombëtare	48,085
Dërgesa postare	11,421
Tatimet dhe Trustet Pensionale për OSh-të nga tarifa për NSh-të përkatëse	20,856
Shpenzimet nga paraja e imët	38,334
Provizione për ruajtjen e artikujve në Bankën Qendrore të Kosovës	3,050
GJITHSEJ PAGESAT E REALIZUARA ME PALËT E JASHTME	2,209,017

Nivelin më të lartë të pagesave të realizuara kundrejt **totalit** për mallra dhe shërbime e kanë Ofruesit e Shërbimeve prej **81.51%** ndërsa me radhë janë shpenzimet për ngrohje qendrore prej EUR **5.56%**.

PARAJA E IMËT

Paraja e imët mbahet për shpenzimet e vogla që bëhen në Zyrat Regjionale për Ndërmarrjet Shoqërore në likuidim si dhe çështjet e privatizimit. Shuma e tërhequr e parasë së imët për avanse për udhëtime zyrtare dhe shpenzimet e vogla për ZR-të është prej EUR **45,310**, shpenzimet e realizuara (mbyllja) nga këto janë EUR 38,334. Ndërsa janë kthyer mjetet prej EUR 6,976 si rezultat i mbylljes të këtyre avanseve.

Avanset e parasë të imët të dhëna kanë qenë prej EUR 41,800 dhe atë:

- ZR Prishtinë prej EUR 5,500; ZR Prizren prej EUR 12,000; ZR Peja prej EUR 8,000; ZR Gjilan prej EUR 9,000; ZR Mitrovicë prej EUR 4,300 dhe për çështje të privatizimit shuma prej EUR 3,000.

Gjithashtu në këtë rast janë tërhequr avanset për udhëtime zyrtare jashtë vendit që kapin vlerën prej EUR 3,510 për të cilat shpenzimet janë prej EUR 2,449

10.1 PAGESAT NDAJ OFRUESVE TË SHËRBIMEVE

Angazhimi i ofruesve të shërbimeve bëhet në përputhje me procedurat të aprovuar nga Menaxhmenti i AKP-së. Përveç procedurave, për rastet e NSh-ve në likuidim, këto shpenzime janë të lejuara sipas kornizës buxhetore të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve. Korniza buxhetore përfshinë 29 lloje të shpenzimeve sipas planit kontabël të fondeve në mirëbesim, brenda të cilave është edhe angazhimi i ofruesve të shërbimeve.

Sipas procedurës, për të angazhuar Ofrues të Shërbimeve për NSh përkatëse, përparësi kanë ish-punëtorët e atyre Ndërmarrjeve Shoqërore.

Gjithsesi, vlen të theksohet se përveç kornizës buxhetore të llojeve të shpenzimeve të lejuara, me aprovim të Bordit caktohet edhe kufiri maksimal i shumës së buxhetuar për shpenzim për 29 kode gjithsej.

Angazhimi i ofruesve të shërbimeve kryesisht bëhet për: **arkivat dhe grumbullimin e dokumentacionit për listat e 20% të punëtorëve, kërkesat e kreditorëve, asistencë në identifikimin e aseteve, ruajtjen e aseteve dhe rastet tjera**. Gjithashtu, angazhimi i ofruesve të shërbimeve është për mbarëvajtjen e punës për NSh-të komplekse të cilat kanë vazhduar aktivitetin e tyre pas hyrjes në likuidim të tilla si: Pallati, Grandi, ABC Genci, dhe Tregu. Gjithashtu në NSh MIM Golesh ka punëtorë të angazhuar.

Bilanci i pagesave për Ofruesit e Shërbimeve dhe punëtorët e MIM Golesh për periudhën raportuese është EUR 1,800,574. Më poshtë i paraqesim pagesat për NSh-të e mëdha që kanë aktivitete duke i përfshirë edhe NSh-të e tjera me pagesat e mëdha.

Detajet e angazhimit të Ofruesve të Shërbimeve janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Shih në faqen tjetër.

NDËRMARRJA	PERIUDHA	NR. I OSh-ve	GJITHSEJ PAGESAT
MIM Golesh	janar – dhjetor 2017	47	204,172
PRN170 Jugopetrol	17 nëntor 2016 – 16 dhjetor 2017	25	30,881
PRN104 Tregu- likuidim	janar – dhjetor 2017	101	286,489
PRN067 Pallat- Likuidim	janar – dhjetor 2017	114	532,198
PRN173 Hotel Grand	janar – dhjetor 2017	86	189,211
PRN066 ABC Genci	janar – dhjetor 2017	19	84,592
GJI018 Morava Partesh	janar dhe qershor - nëntor 2017	4	6,427
GJI023 Zarije Bujic	janar – nëntor 2017	4	10,797
GJI063 Lola Shterpce	janar – nëntor 2017	8	23,238
GJI064 FAM VITI	prill – nëntor 2017	4	8,907
GJI093 Hotel Junior Brezovica	janar – nëntor 2017	4	10,651
GJI170 Xim Strezovci	nëntor 2016 – dhjetor 2017	8	23,770
MIT044 Transkosova	janar – nëntor 2017	4	10,208
PEJ020 Strellci Deçan	shkurt – dhjetor 2017	4	9,728
PEJ089 Ramiz Sadiku	janar – dhjetor 2017	4	11,619
PRN022 Fabrika e letrës	Dhjetor 2011 – Mars 2012	4	2,871
PRN006 Shpezëtaria	janar – nëntor 2017	4	10,651
PRN029 IMN Kosova	janar – dhjetor 2017	10	34,629
PRN030 Izolimi	dhjetor 2016 - korrik 2017	4	11,909
PRN054 Komel Batuse	janar – maj 2017	4	4,363
PRN075 Rilindja Shtypshkronja	janar – dhjetor 2017	20	56,707
PRN093 Gërmia	dhjetor 2016 - gusht 2017	10	25,612
PRN125 Bankos	janar – dhjetor 2017	15	53,339
PRN126 Auto Prishtina	janar – shkurt 2017	12	5,858
PRN167 Auto Moto e Kosovës	janar – nëntor 2017	5	12,379
PRZ009 Lavertari Blegtori	dhjetor 2016 - dhjetor 2017	5	15,258
PRZ014 IGK Ballkan	janar – dhjetor 2017	8	25,046
PRZ018 NSh Unimont	janar – dhjetor 2017	4	13,818
PRZ026 Farmakos	janar – mars 2017	4	7,190
PRN111 Përparimi	tetor – dhjetor 2017	8	6,909
Për 29 NSh-të tjera	janar – dhjetor 2017	41	71,792
Rregullimet/kthimet			(645)
		GJITHSEJ	594
			1,800,574

* Sa i përket numrit të OSh-ve të NSh-ve të shënuar më lartë, ky numër ka ndryshuar në periudhat e ndryshme gjatë vitit fiskal 2017, i cili nuk ka tejkaluar numrin e punëtorëve të lartë shënuar.

Ashtu siç është shënuar më lartë, përveç angazhimit për shërbimet, OSh-të janë të angazhuar edhe për **ruajtjen e aseteve**. Bilanci i pagesave për periudhën janar – dhjetor 2017, për roje të angazhuar për ruajtjen e aseteve është prej EUR 645,113 për 244 roje, ndërsa pjesa tjetër janë të angazhuar për shërbimet tjera.

Nga viti i kaluar, si pjesë strategjike e menaxhmentit të AKP-së është paraparë që ruajtja e aseteve të bëhet nëpërmjet angazhimit të OSh-ve dhe jo nëpërmjet operatorëve ekonomik. Ky veprim ka rezultuar me efekt pozitiv në kursimet e mëdha buxhetore për NSh-të përkatëse krahasuar me periudhat e mëhershme.

11. SHËRBIMET PUBLIKE

Pagesat e realizuara për shërbimet publike (rrymë, ujë, telefoni) kanë të bëjnë me Ndërmarrjet Shoqërore në tranzicion dhe në Likuidim.

Bilanci i pagesave për periudhën raportuse është EUR 731,503. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur pagesat:

PËRSHKRIMI	VLERA
Pagesat e realizuara ndaj palëve të jashtme	731,328
Kompenzimi i llogarisë të tarifës administrative +	175
GJITHSEJ	= 731,503

Kompenzimi i llogarisë të tarifës administrative ka efektin zero të shpenzimeve të përgjithshme të fondeve në mirëbesim. Shuma prej EUR 175 paraqitet si shpenzim (plus) në kategorinë e komunalive ndërsa në anën tjetër është paraqitur si zbritje (minus) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Këto shpenzime kanë ndodhur më parë nga llogaria e tarifës administrative të AKP-së për shpenzimet e NSh-ve përkatëse.

Ndërsa sa i përket pagesave të realizuara nga fondet në mirëbesim ndaj palëve të jashtme, ato janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Këto pagesa janë realizuar nga llogaritë e NSh-ve në tranzicion, likuidim dhe tarifa administrative e Agjencisë.

LLOJET E PAGESAVE	NSH-TË NË TRANZICION	NSH-TË NË LIKUIDIM	GJITHSEJ
Shpenzime për furnizim me ujë	120	82,113	82,233
Shpenzimet për rrymë	12,772	500,119	512,891
Shpenzime për pastrimin e mbeturinave	0.00	125,280	125,280
Shërbimet e telekomunikimit	387	10,537	10,924
GJITHSEJ PAGESAT	13,279	718,049	731,328

12. TATIMET

Pagesat e tatimeve bëhen për NSh-të në tranzicion dhe ato në likuidim, për të hyrat e inkasuara nga qiraja, TVSh-ja, mbajtja në burim e tatimit në të ardhura personale, kontributet pensionale për OSh-të si dhe tatimin në pronë.

Bilanci i pagesave për periudhën raportuse është EUR 1,723,361. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur pagesat:

PËRSHKRIMI	VLERA
Pagesat e realizuara ndaj palëve të jashtme	1,723,945
Kompenzimi i llogarisë të tarifës administrative -	(584)
GJITHSEJ	= 1,723,361

Sa i përket pjesës të kompensimi i tarifës administrative, janë disa raste për të cilat është dashur të mbulohet gjendja e llogarisë bankare nga tarifa për NSh-të. Prandaj më sipër është paraqitur si e zbritshme, ndërsa në anën tjetër është paraqitur si shpenzim tek kategoria mallra dhe shërbime.

Ndërsa sa i përket shpenzimeve me **palët e jashtme**, ato janë paraqitur si më poshtë

LLOJET E PAGESAVE	NSH-TË NË TRANZICION	NSH-TË NË LIKUIDIM	GJITHSEJ
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	186,522	449,998	636,520
Tatimi nga të hyrat e relizuara/qiratë	92,627	131,771	224,398
Kontributet pensionale- Trusti	27,104	153,965	181,069
Tatimi në të ardhurat personale	11,354	59,978	71,332
Tatimi në Pronë – Komunave	25,789	584,837	610,626
GJITHSEJ PAGESAT	343,396	1,380,549	1,723,945

13. VENDIMET E GJYKATAVE/PËRMBARUESVE

Këto pagesa kryesisht kanë të bëjnë me rastet e mëposhtme:

- taksa gjyqësore dhe garancione në Gjykatë; dhe
- vendime të Gjykatave dhe pagesa ndaj përmbaruesve.

Bilanci i pagesave për periudhën raportuese është EUR 33,405 dhe atë:

PËRSHKRIMI	VLERA
Pagesat e realizuara ndaj palëve të jashtme	20,368
Kompenzimi i llogarisë të tarifës administrative +	13,037
GJITHSEJ =	33,405

Kompenzimi i llogarisë të tarifës administrative ka efektin zero të shpenzimeve të përgjithshme të fondeve në mirëbesim. Shuma prej EUR 13,037 paraqitet si shpenzim (plus) në kategorinë e shpenzimeve të gjykatave ndërsa në anën tjetër është paraqitur si zbritje (minus) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Këto shpenzime kanë ndodhur më parë nga llogaria e tarifës administrative të AKP-së për shpenzimet e NSh-ve përkatëse.

Ndërsa sa i përket pagesave të realizuara nga fondet në mirëbesim **ndaj palëve të jashtme**, ato kryesisht janë për Këshillin Gjyqësor të Kosovës në shumën prej EUR **19,280 e që në vete përbën shpenzimet e taksave gjyqësore dhe depozitat e sigurisë.**

Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur ndonjë pagesë me vendim përmbarimor. Gjithsesi, vlen të theksohet se për NSh-të në likuidim, është mbrojtja ligjore sipas nenit 10 të shtojcës të Ligjit nr. 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

14. TRANSFERIMI I MJETEVE 5% PËR MBULIMIN E AKTIVITETEVE TË AKP-së

Agjencia Kosovare e Privatizimit që nga vitit 2011 e deri më datën raportuese ka transferuar gjithsej shumë prej EUR 38,248,000 në llogarinë bankare të Thesarit të Ministrisë së Financave për financimin e aktiviteteve administrative dhe operative të AKP-së:

PËRSHKRIMI DHE DATA E TRANSFERËVE	PËR BUXHETIN E VITIT	VLERA
Transfer gjatë vitit 2011	2011	1,800,000
Transfer me 28 Maj 2012	2012	8,200,000
Transfer me 28 Dhjetor 2012	2013	8,048,000
Transfer shtesë me 18 Nëntor 2012	2014	2,300,000
Transfer shtesë me 15 Janar 2015	2015	5,500,000
Transfer shtesë me 15 Janar 2016	2016	6,300,000
Transfer shtesë me 20 Janar 2017	2017	6,100,000
GJITHSEJ PAGESAT		38,248,000

Tabela e sipër shënuar, nuk paraqet bilancin e të hyrave të dedikuara të realizuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, por paraqet shumat e transferuara nga llogaria e tarifës administrative të AKP-së prej EUR 36,448,000 si dhe fondit rezervë prej EUR 1,800,000. Këto mjete janë transferuar në të mirë të llogarisë në Thesar të Ministrisë së Financave, llogari e cila veçanërisht është hapur për tarifën administrative të AKP-së. Këtë llogari e menaxhon dhe administron Departamenti i Thesarit të Ministrisë së Financave.

14.1 TË HYRAT E REALIZUARA PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Nga viti 2003 deri në datën raportuese për të gjitha shitjet dhe të hyrat e tjera (konfiskime të BID depozitave dhe tarifa për pjesëmarrje të tenderëve) gjithsej të hyrat e realizuara janë EUR 43,636,465.

Ndërsa të hyrat e realizuara vetëm për periudhën raportuese janë EUR 3,018,473 dhe atë:

PËRSHKRIMI	Lloji i të hyrave	Vlera
Llogaria e fondit rezervë të AKP-së	Konfiskimet e BID depozitave	1,162,515
Llogaria e tarifës për pjesëmarrje në tender	Tarifa për pjesëmarrje në tenderë/konfiskime dep.	540,000
Llogaritë e Ndërmarrjeve të Reja	5% e vlerë së të shitjeve (kon. të nënshkruara)	10,157
Llogaritë e NSh-ve në likuidim	5% e vlerë së të shitjeve (kon. të nënshkruara)	1,305,801
GJITHSEJ PAGESAT		3,018,473

Ndërsa gjendja bankare e llogarisë të tarifës administrative më 31 dhjetor 2017 është EUR 6,086,620

Çështje me rëndësi që duhet theksuar është mungesa e mjeteve në llogarinë e tarifës administrative, nëpërmjet të cilës financohen aktivitetet administrative dhe operative të AKP-së. Ashtu siç është paraqitur më lartë, AKP-ja ka inkasuar 5% nga shitjet e realizuara nga viti 2003 e tutje. Këto mjete janë shpenzuar për buxhetet e viti 2012 deri në vitin 2018.

Duke filluar nga viti 2019, sipas Ligjit aktual, përkatësisht nenit 21, AKP-ja nuk do të ketë mjete në dispozicion që të mbulojë aktivitetet e saj administrative dhe operative. Mungesa e mjeteve, nuk do të mundësojë përmbushjen

e misionit dhe objektivave të përcaktuar sipas këtij Ligji, nëpërmjet të cilës është themeluar Agjencia Kosovare e Privatizimit, si përgjegjëse kryesore në zbatim të këtij Ligji.

Në përputhje me nenin 21 të Ligjit nr. 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit:

Të gjitha të ardhurat e Agjencisë do të jenë të ardhura të dedikuara të Agjencisë sipas nenit 64 të LMFP-së. Përveç kësaj, pesë përqind (5%) e të gjitha të hyrave të pranuar si rrjedhojë e çfarëdo shitje në të kaluarën apo të ardhmen, transferimit, privatizimit, likuidimit apo mënyrave tjera të disponimit me cilëndo ndërmarrje apo aset, pavarësisht nëse është bërë nga agjencia apo paraardhësja e saj, do të jetë tarifë administrative e Agjencisë për të mbuluar shpenzimet e veta të përgjithshme administrative dhe operative; dhe ajo tarifë do të jetë pjesë e të ardhurave të dedikuara të Agjencisë. Agjencia menjëherë transferon dhe depoziton të gjitha ato të ardhura nga tarifa në Fondin e Konsoliduar të Kosovës në pajtim me rregullat në fuqi të LMFP-së; Thesari dhe Ministria e Financave sigurojnë që ato fonde të vendosen dhe mbahen në llogarinë e dedikuar të të ardhurave të Agjencisë.

15. SHPENZIMET TJERA

Këto shpenzime përfshijnë avanset për udhëtime zyrtare të Zyrtarëve Ligjor dhe Zyrtarëve të Rastit për NSh-të në likuidim (përfaqësime gjyqësore jashtë territorit të Kosovës) dhe pagesat e tarifave për transaksionet dalëse nga llogarit bankare të fonde në mirëbesim që i aplikon BQK.

Bilanci i pagesave për periudhën raportuese EUR 34,286. Llojet e shpenzimeve për periudhën në fjalë janë si më poshtë:

PËRSHKRIMI	VLERA
Pagesat e realizuara ndaj palëve të jashtme	32,960
Kompenzimi i llogarisë të tarifës administrative +	1,326
GJITHSEJ	= 34,286

Kompenzimi i llogarisë të tarifës administrative ka efektin zero të shpenzimeve të përgjithshme të fondeve në mirëbesim. Shuma prej EUR 1,326 paraqitet si shpenzim (plus) në kategorinë e shpenzimeve tjera ndërsa në anën tjetër është paraqitur si zbritje (minus) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Këto shpenzime kanë ndodhur më parë nga llogaria e tarifës administrative të AKP-së për shpenzimet e NSh-ve përkatëse.

Ndërsa sa i përket pagesave të realizuara nga fondet në mirëbesim ndaj palëve të jashtme, ato kryesisht janë për paranë e imët dhe shpenzimet e tarifave bankare. Shih tabelën e mëposhtme:

LLOJET E PAGESAVE	VLERA
Paraja e imët në avans për shpenzime të vogla	14,163
Avansë për udhëtime zyrtare jashtë vendit	10,641
Shpenzime bankare/tarifa për transaksion	8,156
GJITHSEJ PAGESAT	32,960

16. PAGESAT NDAJ KREDITORËVE TË NSH-ve NË LIKUIDIM

Bilanci i pagesave për periudhën raportuese EUR 8,105,856 për 63 Ndërmarrjeve Shoqërore dhe atë:

LLOJET E KREDITORËVE	PËR VENDIMET E 2017	PËR VENDIMET E 2016	GJITHSEJ
Për paga të punëtorëve	4,049,214	378,665	4,427,879
ATK-ja	855,314	333,078	1,188,392
Trusti	565,624	95,702	661,326
Tatimi në pronë	317,945	2,753	320,698
Shërbimet publike	88,251	71,642	159,893
Kreditor të tjerë	692,105	655,563	1,347,668
GJITHSEJ	6,568,453	1,537,403	8,105,856

Ndërsa sa i përket tërë procesit nga viti 2011 deri më 31 dhjetor 2017, shumat e aprovuara dhe paguara janë sipas tabelës të mëposhtme:

LLOJET E KREDITORËVE	SHUMAT E APROVUARA			PAGESAT 2011 - 2017	PAPAGUAR
	JANAR – DHJETOR 2017	DERI MË 31 DHJETOR 2016	GJITHSEJ		
Për paga të punëtorëve	4,268,362	6,507,567	10,775,929	10,530,898	245,031
ATK-ja	856,282	3,984,328	4,840,610	4,839,527	1,083
Trusti	575,079	1,718,988	2,294,067	2,283,218	10,849
Tatimi në pronë	320,739	967,402	1,288,141	1,285,348	2,793
Shërbimet publike	109,882	798,095	907,977	881,023	26,954
Kreditor të tjerë	692,917	3,483,193	4,176,110	4,157,870	18,240
GJITHSEJ	6,823,261	17,459,573	24,282,834	23,977,884	304,950

*Në këto shuma nuk përshihen tarifat bankare. Gjithsej pagesat e tarifave bankare është EUR 3,469.40 për transaksionet e realizuara.

Shumat e papaguar janë si rezultat i mungesës të informacioneve të sakta dhe llogarive jo aktive bankare për të cilët ka pasur vështirësi në gjetjen e kontakteve të personave në fjalë.

INFORMATË

- Në vitin 2015, ATK-ja me kërkesën e saj ka rezervuar mjetet prej EUR 192,357 për NSH në likuidim "Jugoterm". Mjetet e rezervuar në BQK janë si rezultat i vendosjes së barrës tatimore mbi asetet e kësaj NSH-je. AKP ka nënshkruar një "Marrëveshje të Mirëkuptimit" me ATK për trajtimin e barrës tatimore, por për rastin në fjalë është vendosur që të trajtohet deri në vendimin e Dhomës të Gjykatës Supreme të Kosovës;
- Në vitin 2016, shuma prej EUR 6,893 të dedikuara për tatimin në pronë të kreditorit të Komunës të Skenderaj janë tërhequr nga ATK-ja si rezultat i vendosjes së "Barrës tatimore". Tërheqja është bërë nga sistemi i Thesarit të Ministrisë së Financave. Kemi kërkuar që këto mjete të kthehen në llogari të AKP-së.

3. Për arsye të emrit dhe mbiemrit të njëjtë të dy kreditorëve, gjatë realizimit të pagesës në vlerë prej EUR 976.20, një kreditor ka përfituar më shumë për NSh “Trasing”. Nga Zyrtari i rastit, kreditori është njoftuar që t’i kthej mjetet dhe njëkohësisht janë marrë masat ligjore për rastin në fjalë.
4. Në Mars të vitit 2015, BQK-ja ka ekzekutuar urdhrin e përmbaruesit privat në shumën 3,194 për NSh në likuidim “Malishgani Klinë”. AKP-ja ka marrë të gjitha hapat ligjor dhe ka kërkuar kthimin e mjeteve. Të gjitha institucionet relevante janë njoftuar për rastin në fjalë.
5. Në fund të dhjetorit 2017, të hyrat prej EUR 2,460 për NSh Grand për shfrytëzimin e sallës nga AKP-ja, gjatë ekzekutimit të pagesës janë konfiskuar nga ATK-ja. Kjo si rezultat i marrëveshjes në mes të ATK-së dhe Thesarit, nëpërmjet të cilës, përmes sistemit automatikisht ekzekutohen pagesat në të mirë të ATK-së;
6. Gjithashtu, në vitin 2017 jemi njoftuar se, ATK-ja ka konfiskuar mjetet prej EUR 24,309 që është dashur të paguaj institucioni i Kosovës për shfrytëzimin me qira të asetit të NSh Mekanizimi. Mjetet janë konfiskuar në vitin 2016. Mënyra e konfiskimit të mjeteve është ngjajshëm si në rastin e sipër shënuar në pikën 5.

17. FONDET TEPRICË TRANSFERUAR QEVERISË SË KOSOVËS

Në përputhje me nenin 19.3.3 i Ligjit të AKP-së, deri më 31 Dhjetor 2015 shuma totale e transferuar si “fonde tepriçë” është EUR 90,244,911. Gjatë periudhës raportuese **nuk ka pasur** transferim të mjeteve tepriçë në Llogarinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ndërsa, sa i përket transferimit të mjeteve të fondeve të mbetura Qeverisë së Kosovës, gjatë periudhës janar – dhjetor 2017 janë transferuar mjetet prej **EUR 325,664 nga llogaria bankare e NSh MIT046 “Den Des”, pasi që procesi i likuidimit për këtë NSh ka përfunduar dhe me vendim të Gjykatës është mbyllur ndërmarrja.**

Gjithashtu, vlen të theksohet se, Agjencia Kosovare e Privatizimit ka dërguar në Qeveri, sugjerimet për ndryshimet e Ligjit e AKP-së dhe në pajtim me Qeverinë pritët që të përcillet në Kuvend për aprovim.

LLOGARITË E ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme janë obligimet e papaguara nga palët e treta ndaj Agjencisë, të cilat paraqiten vetëm si shpalosje. Llojet e të hyrave për Agjencinë janë si më poshtë:

- pjesët e papaguara nga valët e privatizimit apo likuidimit;
- ndëshkimet financiare për valët e “spin off-ve special”; dhe
- qiratë apo të hyra të tjera nga asetet e NSh-ve.

Të gjitha këto të dhëna janë të paraqitura nga Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje, Zyrat Regjionale përmes Departamentit të Koordinimit të Rajonal dhe Departamenti i Shitjes.

Ashtu siç është paraqitur edhe më lartë, sa i përket llogarive të arkëtueshme janë paraqitur vetëm si shpalosje në këto pasqyra, pasi që pasqyrat financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) janë përgatitur në pajtim me SNKSP (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik) e bazuar në para të gatshme.

Gjendja e llogarive të arkëtueshme deri më 31 dhjetor 2017 është si më poshtë:

DEPARTAMENTET/ NJËSITË DHE REGJIONET	DERI MË 31 DHJETOR 2016	NDRYSHIMET GJATË VITIT 2017	GJITHSEJ	LLOJET E LLOGARIVE TË ARKËTUESHME		
				NDËSHKIME PËR SPIN- OFF SPECIALE	SHITJE E ASETEVE NË PRIVATIZIM DHE LIKUIDIM	QIRA TË PAINKASUA RA
Njësia e Monitorimit të NSh-ve	34,437,433	(4,544,148)	29,893,285	29,893,285	0.00	0.00
Departamenti i Shitjes	5,818,388	12,276,909	18,095,297	0.00	18,095,297	0.00
ZR Prishtina	10,897,988	412,182	11,310,170	0.00	0.00	11,310,170
ZR Pejë	69,216	(2,163)	67,053	0.00	0.00	67,053
ZR Mitrovicë	919,634	83,547	1,003,181	0.00	0.00	1,003,181
ZR Gjilan	1,351,502	5,046	1,356,548	0.00	0.00	1,356,548
ZR Prizren	43,098	22,440	65,538	0.00	0.00	65,538
GJITHSEJ	53,537,259	8,253,813	61,791,072	29,893,285	18,095,297	13,802,490

18. NDËSHKIMET NDAJ NSh-ve ME SPIN-OFF SPECIAL

Janë ndëshkimet në vlerë monetare ndaj blerësve për zotimet e dhëna për disa Ndërmarrje të Reja, që përveç çmimit të ofertës, ofertuesit kanë dorëzuar dhe ofertat lidhur me investimet për këto Ndërmarrje.

Shitjet janë realizuar edhe me kushte të tilla si: vazhdimi i operimit të aktivitetit të NSh-ve, me investimet e zotuar dhe numrin e punëtorëve. Këto raste kanë qenë **“Shitjet me Kushte të Veçanta”** dhe shitjet me **“Spin Off Special”**.

Deri më tani, ndëshkimet financiare e aplikuar për blerësit të cilët nuk i kanë përmbushur zotimet për NSh-të e mëposhtme janë:

	1	2	3	4	5Σ(1:4)
	31	31	31	31	
LLOJET E KREDITORËVE	DHJETOR	DHJETOR	DHJETOR	DHJETOR	GJITHSEJ
	2014	2015	2016	2017	
Grand Hotel	8,822,315	0.00	0.00	0.00	8,822,315
IDGJ Tobacco	4,573,649	0.00	0.00	(4,544,149)	29,500
Xim Strezovc	7,298,171	0.00	0.00	0.00	7,298,171
MIM Golesh	8,447,812	0.00	0.00	0.00	8,447,812
Agrokosova Holding	3,579,998	0.00	0.00	0.00	3,579,998
Llamkos	1,686,460	29,029	0.00	0.00	1,715,489
GJITHSEJ	34,408,405	29,029	0.00	(4,544,149)	29,893,285

Lidhur me ndëshkimet financiare, AKP ka angazhuar ekspertin ligjor dhe duke u bazuar në opinionin e ekspertit ligjor, Menaxhmenti i AKP-së ka dorëzuar memorandum në Bord të Drejtorëve.

Rekomandimet e dorëzuara për Bord të Drejtorëve janë që ndërmarrjet për të cilat i janë tërhequr aksionet “Grand Hotel”, “XIM” Strezovc dhe “MIM” Golesh të ndërmerren hapat ligjor për inkasimin e tyre, për ndërmarrjen “IDGJ Tobacco”, sipas kontratës të vitit 2012 të shlyhen ndëshkimet financiare dhe për ndërmarrjet “AgroKosova Holding” dhe “Llamkos Galvasteel” të priten vendimet gjyqësore dhe pastaj të ndërmerren hapat e mëtutjeshëm.

Bordi i Drejtorëve ka vendosur që ndëshkimet financiare të vendosura për Ndërmarrjen e Re “IDGJ Tobacco” para kontratës së novacionit në vlerë prej EUR 4,573,649 të shlyhen nga pasqyrat financiare bazuar në kontratën e novacionit të vitit 2012 kurse për po të njëjtën ndërmarrje të aplikohen ndëshkimet në vlerë prej EUR 29,500 për mos përmbushje në tërësi të zotimeve për punësim për periudhën 2012 – Prill 2015.

Gjithashtu Bordi i Drejtorëve ka vendosur që menaxhmenti të bëjë analizë të mëtutjeshme për propozimin për ndëshkimet financiare për ndërmarrjet që iu janë tërhequr aksionet kurse për ndërmarrjet “AgroKosova Holding” dhe “Llamkos Galvasteel” të priten vendimet gjyqësore dhe pastaj të ndërmerren hapat e mëtutjeshëm.

19. SHITJA E ASETVE PËRMES VALËVE TË PRIVATIZIMIT

Gjendja e llogarive të arkëtueshme deri më 31 dhjetor 2017 është **EUR 18,095,297**. Nga viti paraprak 2016, llogaritë e arkëtueshme janë rritur kryesisht si rezultat i valës 28 deri në 38 të “shitjes të asetve përmes likuidimit”.

Shitja 27 për disa asete në likuidim është shpallur më 7 dhjetor 2016 dhe është raportuar në llogaritë e arkëtueshme 2016. Të gjitha shitjet tjera nga vala 28 deri në 38 (dita ofertuese në dhjetor 2017) janë pjesë përbërëse e llogarive të arkëtueshme 2017. Të gjitha shitjet e SHA janë të aprovuara nga Bordi i AKP-së që kanë ndikuar në rritjen e llogarive të arkëtueshme.

Më poshtë paraqesim ngjarjet gjatë periudhës raportuese të llogarive të arkëtueshme:

LL/A - VITI	PËRSHKRIMI		VLERA
2016	Bilanci i llogarive të arkëtueshme deri më 31 Dhjetor 2016		5,818,388
2016	Pagesat gjatë 2017 të valës 27 – asetet përmes likuidimit	-	(3,777,660)
2016	*Anulimet/tërheqjet nga tenderit të valës 27 përmes likuidimit	-	(1,399,594)
2016	Pagesat pas lirimit nga masa e përkohshme – <i>shih shënimin shpjegues nr. 1</i>	-	(24,000)
2016	Gjendja e llogarive të arkëtueshme të bartura në vitin 2017	=	617,134
2017	Pagesat e përealizuara për Shitjet për valën 28 – 38	+	17,478,163
2017	LLOGARITË E ARKËTUESHME MË 31 DHJETOR 2017	=	18,095,297

*Shuma prej EUR 1,399,594 është bilanci i anulimeve/tërheqjeve nga tenderët prej EUR **1,450,194** dhe zbritjes prej EUR 40,500 të depozitave të konfiskuar si dhe kthimin e BID depozitit prej EUR 10,100 për anulim tenderi. Totali i BID depozitave prej EUR 55,100 të këtyre anulimeve kanë qenë të paguara në vitin 2016 të cilat janë prezantuar si zbritje e llogarive të arkëtueshme në vitin 2016.

Pjesën më të madhe të këtyre llogarive të arkëtueshme e përbëjnë shitja e valëve të fundit 36 - 38 të realizuar (dita e ofertës) në tremujorin e fundit. Vlera e tërësishme e llogarive të arkëtueshme për këto valë është EUR **14,856,524**.

MASAT E PËRKOHËSHME NGA DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME

Llogaritë e arkëtueshme që janë bartur nga viti 2016 prej EUR **617,134** kanë të bëjnë vendosjen e masës të përkohshme nga DHPGJSK

- Privatizim Vala 37 për Agrokosova Offices shuma prej EUR 321,111;
- Privatizim Vala 43 për Punëtorja Iliria në shumën prej EUR 223,223; dhe
- Likuidim 20 për asetin e Nsh Lavërtari Blegtori në shumën prej EUR 72,800.

Gjithashtu për shitjet **gjatë vitit 2017** janë vendosur masa të përkohshme edhe për shitjet e mëposhtme të cilat janë pjesë e llogarive të arkëtueshme. Shuma totale këtyre rasteve është EUR 2,461,558 dhe atë:

- Likuidimi 29 për NSh Rekreators, njësia 34 në shumën prej EUR 70,777;
- Likuidimi 35 për NSh Gërmia, njësia 43 në shumën prej EUR 1,800,000;
- Likuidimi 35 për NSh Zetatrans, njësia 47 në shumën prej EUR 112,456; dhe
- Likuidimi 35 për Nsh Lavërtari Blegtori, njësia 55 në shumën prej EUR 478,325.

20. QIRAJA APO TË HYRAT TË TJERA

Faktorët kyç në rritjen e llogarive të qirave gjatë periudhës 2014 deri në 2017 kanë qenë si më poshtë:

1. Vendosjen në likuidim të NSh Tregu, Pallati i Rinisë, Hotel Grand dhe ABC Genci. Nga këto janë trashëguar edhe obligimet e papaguara të qirave së bashku me probleme tjera. Për Agjencinë, sfidë në vete është menaxhimi me këto NSh komplekse, pasi që këto NSh kanë vazhduar aktivitetin e tyre ekonomik edhe pas hyrjes në likuidim;
2. Rritje të mëdha të numrit të qiramarrësve që kanë pranuar të nënshtrohen nënshkrimit të kontratave për shfrytëzimin e aseteve të NSh-ve. Meqenëse tani kemi inkasim të lartë të qirave, në të njëjtën kohë do të kemi edhe rritje të llogarive të arkëtueshme, për të cilat AKP-ja ka marrë veprime konkrete përmes përmbarusve privat dhe padive gjyqësore;
3. Faturimi ndaj Kosova Petrol për shfrytëzimin e aseteve të NSh-ve "INA TRGOVINA" dhe "JUGOPETROL" për periudhën nga Shkurti i vitit 2000 deri më 30 Prill 2016. Obligimi është EUR 8,708,329. Fatura e parë për obligimet është lëshuar gjatë vitit 2014. Për shfrytëzimin e këtyre aseteve për periudhën e sipër shënuar është ngritur padi ndaj Kosova Petrol në organet përkatëse.

Ashtu siç janë paraqitur tek tabela kryesore për llogaritë e arkëtueshme të qirave prej EUR **13,802,490** janë ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

	A	B	C=A+B	D=A/C	E=B/C
QIRATË PËR NSh-të	QIRAMARRËSITË E RREGULLTË	PADI GJYQËSORE	GJITHSEJ QIRAJA E PAPAGUAR	%	%
ZR Prishtinë	1,614,883	9,695,287	11,310,170	14%	86%
ZR Peja	12,898	54,155	67,053	19%	81%
ZR Mitrovicë	74,708	928,473	1,003,181	7%	93%
ZR Gjilan	7,045	1,349,503	1,356,548	1%	99%
ZR Prizren	9,422	56,116	65,538	14%	86%
GJITHSEJ	1,718,956	12,083,534	13,802,490	12%	88%

LLOGARITË E PAGUESHME DHE DETYRIMET KONTIGJENTE

Obligimet e papaguara janë të paraqitura në tri shtylla:

1. Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoriteti i Likuidimit);
2. Mallrat dhe Shërbimet; dhe
3. Obligimet ndaj Kërkesave të Kreditorëve;

Obligimet e papaguara deri më 31 dhjetor 2017 janë si më poshtë:

Departamentet/ Njësitë dhe Regjionet	1Σ(1:4)			LLOJET E LLOGARIVE TË PAGUESHME		
	Deri më 31 Dhjetor 2016	Ndryshimet Gjatë Vitit 2017	Gjithsej	2	3	4
				Ofruesi i Shërbimeve Profesional e	Mallra dhe Shërbime	Kreditorët e NSh-ve
Departamenti i Likuidimit	1,591,507	(1,285,420)	306,087	0.00	1,137	304,950
ZQ – Mim Golesh	0.00	328	328	0.00	328	0.00
ZR Prishtinë	31,137	12,013	43,150	0.00	43,150	0.00
ZR Mitrovicë	0.00	1,807	1,807	0.00	1,807	0.00
ZR Pejë	0.00	193	193	0.00	193	0.00
ZR Gjilan	18,057	3,202	21,259	0.00	21,259	0.00
ZR Prizren	1,356	2,813	4,169	0.00	4,169	0.00
GJITHSEJ	1,642,057	(1,265,064)	376,993	0.00	72,043	304,950

Sa i përket obligimeve, ato njihen nga data e pranimit të faturë. Ndërsa për Ofruesit e Shërbimeve me përfundimin e shërbimeve.

Shuma prej EUR 304,950 e papaguar e paraqitur për kreditorët mund të ketë ndryshime, për shkak të kthimit të mjeteve (mos ekzekutimit) nga bankat komerciale për mos ekzekutim të pagesës. Pra mund të ketë ende raste që nuk janë ekzekutuar e që bankat na njoftojnë në janar 2018.

21. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE

Sa i përket obligimeve ndaj OShP-së, për periudhën e përfunduar më 31 Dhjetor 2017, nuk ka asnjë faturë pa paguar. Si pjesë e kontraktuar, bilanci i papaguar paraqet mjetet në dispozicion sipas vlerës të kontraktuar dhe është obligim për vitin 2018 vetëm për pjesën e aneks kontratës me kontraktorin

Për OShP-në, më gjerësisht është shpalosur në *shënimin shpjegues nr. 9*

22. MALLRA DHE SHËRBIME

Shuma prej **EUR 72,043** janë për ofruesit e shërbimeve të cilët angazhohen për NSh-të përkatëse, shërbimet për ruajtjen e aseteve, shpalljet në gazeta për shitjen e aseteve përmes likuidimit, shpalljet lidhur me njoftimet për kërkesat e kreditorëve, qiraja, shërbimet publike dhe të tjera.

Më poshtë janë paraqitur detajet. Shih në faqen tjetër.

PËRSHKRIMI I SHPENZIMEVE TË NDODHURA

VLERA

Shpallje në gazeta	1,136
Shpenzimet për ofruesit e Shërbimeve	16,124
Paga e muajit dhjetor për punëtorin e MIM Golesh	328
Shpenzimet për shërbimet e sigurimit fizik për ruajtjen e aseteve me operatorët ekonomik	19,436
Qiraja për muajin dhjetor 2017 nga NSh Tregu për pronësinë e përbashkët	3,000
Shërbimet profesionale/matje kadastrale	2,724
Shpenzimet e telekomunikimit	1,351
Shpenzimet për pastrimin e mbeturinave	12,628
Shpenzime për rrymë	14,291
Shërbime të marketingut	237
Furnizim me material higjienik dhe artikuj ushqimor për NSh Grandi dhe ABC Genci	738
Tjera	50
GJITHSEJ	72,043

Sa i përket Ofruesve të Shërbimeve, si obligim janë të paraqitura shuma e përgjithshme të pagave bruto me 5% e punëdhënësit. Pagat neto janë paguar në muajin janar 2018 në shumën prej **EUR 14,156 për gjithsej 55 persona**. Pjesa tjetër prej EUR 1,967 (16,124 – 14,156) janë tatime dhe kontributet pensionale që do të procesohen nga muaji Shkurt 2018 si rezultat i hapjes të llogarisë tatimore për periudhën e pagesave të Janarit 2018.

23. OBLIGIMET NDAJ KREDITORËVE TË NSh-ve

Ashtu siç është përmendur edhe në *shënimin shpjegues nr. 16*, obligimet e papagura janë pagesat e parealizuara ndaj kreditorëve të NSh-ve sipas vendimit për shpërndarje të Bordit të Drejtorëve.

Gjithsej shuma e vendimeve të aprovuar në Bordine Drejtorëve është EUR 24,282,834. Ndërsa pagesat janë realizuar prej EUR 23,977,884.

Vlera e mbetur për tu paguar prej EUR 304,950 janë si rezultat i mungesës të informacioneve të sakta të llogarive bankare. AKP-ja ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të vënë në kontakt kreditorët në fjalë (edhe përmes reklamave në TV). AKP-ja së fundi ka vënë në përdorim edhe aplikacionin në uebfaqen e saj zyrtare në mënyrë që kreditorët të informohen me të dhënat e fundit rreth procesit të shpërndarjes. Këto veprime kanë pasur efekt në shpërndarjen e informacionit ndaj kreditorëve për të cilët janë aprovuar shumat për shpërndarje.

24. DETYRIMET KONTIGJENTE

Janë konteste gjyqësore të pazgjidhura për një numër të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Detyrimet kontingjente janë të shpalosura në këtë format: Kolona 1 paraqet totalin e shumave të periudhës 2016, kolona 2 paraqet rastet e reja dhe të bartura nga viti 2016. Ndërsa kolona 3 paraqet totalin e të gjitha vlerave të bartura, të raportuara të bilanceve deri më 31 Dhjetor 2017.

Detajet në lidhje me detyrimet kontigjente janë paraqitur në Tabelën e më poshtme:

		1	2	3=1+2	
NATYRA	ARSYEJA PËR DETYRIME	MUN DËSIA	VLERA POTENCIALE 2016	VLERA POTENCIALE 2017	GJITHSEJ
Kontratë	Sipas Urdhrit Përmbarues P.nr.479/15, kompensim në shumë prej 8.216.91 Euro	e ultë	8,217	0.00	0.00
Kontratë	Sipas Urdhrit Përmbarues P. nr.397/2015, kompensim në shumë prej 2.640.00 Euro	e ultë	2,640	2,640	2,640
Kontratë	Sipas Urdhrit Përmbarues P. nr.1342/11, kompensim në shumë prej 3.440.00 Euro	e ultë	3,440	0.00	0.00
Kontratë	Sipas Aktgjykimit SCC-09-0135, shpenzime procedurale, në shumë prej 1500 Euro	e ultë	1,500	1,500	1,500
Kontratë	Sipas Aktgjykimit SCC-08-0095 - Padia për humbjen e fitimit, kompensimit në shumën prej 14,478,50 si dhe avokatin në shumën prej 365,04 Euro.	e ultë	14,844	14,844	14,844
Kompensim	Sipas Aktgjykimit SCC-07-0059-Urdhërohet AKM-ja, t’ia bëjë pagesën prej 59,807,04, si dhe shpenzimet e gjykatës prej 780 eurove. Nsh Famipa	e ultë	60,587	60,587	60,587
Kompensim	Aktgjykimi SCC-10-00214, AKP-ja detyrohet për pagesën e 35,400. NSh Magjistratja Peje	e ultë	35,400	35,400	35,400
Kompensim	Aktgjykimi SCC-06-0348, NSH Ratko Mitrovicë	e ultë	122,994	122,994	122,994
Kompensim	Aktgjykimi SCC-10-0091, AKP-ja detyrohet për pagesën e 113.794	e ultë	113,794	113,794	113,794
Kompensim	Aktgjykimi Cnr.190/2007 NSH Auto Prishtina	e ultë	35,725	35,725	35,725
Kompensim	Aktgjykimi Cnr.185/2009. për NSh Ujmiri në likuidim	e ultë	70,000	70,000	70,000
Kompensim	aktgjykim AC-II-12-0006 për NSH Agrokultura	e ultë	2,296	2,296	2,296
Kompensim	Sipas aktgjykimit AC-I-17-0257, agjencia është e obliguar t’i paguaj shpenzimet procedurale	e ultë	0.00	203	203.00
Kompensim	Sipas Aktgjykimit C-II-14-0118, kompensimi i të ardhurave personale	e ultë	0.00	26,247	26,247
Kompensim	Lënda nr. SCC-08-0199 Kërkesë për shërbime menaxheriale nga KEK-u.	e ultë	0.00	4,945,129	4,945,129
Kompensim	Sipas aktgjykimit C-II-17-0069, AKP-ja është e obliguar t’i paguaj shpenzimet e përfaqësuesit të ankuesit	e ultë	0.00	655	655
GJITHSEJ			471,437	5,432,014	5,432,014

PAGESAT E REALIZUARA NGA TARIFA ADMINISTRATIVE

Sipas ventimit të Bordit të Drejtorëve të vitit 2012, në rast se nuk ka fonde të mjaftueshme në llogarinë bankare të likuidimit dhe NSh-ve tjera, atëherë pagesat realizohen përkohësisht nga llogaria bankare e tarifës administrative të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në momentin që do të ketë fonde të mjaftueshme në llogarinë e likuidimit, atëherë llogaria e tarifës administrative të Agjencisë kompensohet nga llogaria e ndërmarrjes në likuidim.

Gjatë periudhës raportuese, bilanci i hyrjeve/daljeve nga llogaria e tarifës administrative është si më poshtë:

Gjendja bankare e llogarisë së tarifës administrative më 31 Dhjetor 2016	7,223,136
Shuma e transferuar shtesë për buxhetin e vitit 2017- <i>shënimin shpjegues nr. 14</i>	- (6,100,000)
Gjithsej mjetet e paguara për tarifën fikse sipas aneks kontratës- <i>shënimin shpjegues nr. 9</i>	- (996,000)
Shpenzime për dërgesa postare <i>shënimi nr. 10</i>	- (11,421)
Bilanci i pagesave për Ofruesit e Shërbimeve <i>shënimi nr. 10.1</i>	- (160,519)
Provizione për ruajtjen e aseteve <i>shënimi nr. 10</i>	- (3,050)
Shërbime profesionale – Angazhimi i përmbauesve apo përfaqësime ligjore <i>shënimi nr. 10</i>	- (830)
Shpalle në gazeta vendore dhe ndërkombëtare <i>shënimi nr. 10</i>	- (46,712)
Shpenzime të marketingut, përkthime, auditimi, taksa gjyqësore dhe tjera <i>shënimi nr. 10</i>	- (1,165)
Tatimet dhe Trustet Pensionale për OSh-të nga tarfia për NSh-të përkatëse <i>shënimi nr. 10</i>	- (20,856)
Shpenzime bankare <i>shënimi nr. 15</i>	- (1,190)
Shpenzimet nga avansi për udhëtim zyrtar/paraja e imët në tarifën administrative të AKP-së	- (38,334)
Rimbursimi i mjeteve nga llogaritë e NSh-ve që janë paguar nga tarifa administrative	+ 132,012
Të hyrat për Agjencinë Kosovare të Privatizimi – <i>shih shënimin shpjegues nr. 14.1</i>	+ 3,018,474
Rimbursimi i mjeteve nga llogaritë e NSh-ve për koston fikse të OShP-së	+ 3,093,075
Gjendja në fund të periudhës raportuese më 31 Dhjetor 2017	= 6,086,620

TRANSFERET BRENDË LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM NË BQK DHE GJENDJA NË BANKAT KOMERCIALE

TRANSFERET BRENDË LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

Janë transaksione bankare ndërmjet llogarive bankare të fondeve në mirëbesim në BQK. Shkurtimisht janë paraqitur si më poshtë:

1. Shpërndarja e 75% nga llogaritë e privatizimit për në llogaritë bankare të likuidimit prej **EUR 367,241**;
2. Transferimi i gjendjes bankare të NSh-ve në tranzicion prej **EUR 415,433** dhe llogaritë e komercializimit prej **EUR 3,667,271**. Në total mjetet janë transferuar për në llogaritë bankare të likuidimit prej **EUR 4,082,705**;
3. Konfiskimin e depozitave nga llogaritë e BID depozitave të privatizimit dhe likuidimit prej EUR 162,500
4. Bartjen e BID depozitave nga llogaritë e BID depozitave të privatizimit dhe likuidimit për në llogaritë përkatëse të NSh-ve në likuidim. *Këto raste janë të paraqitura në shënimin nr. 1, 4 dhe 5.* Gjithsej shuma e transferuar prej **EUR 3,234,008**;
5. Kompensimi i llogarisë të tarifës administrative nga llogaritë e NSh-ve përkatëse në vlerën prej **EUR 3,093,075**; Këto mjete janë kompensuar nga pagesat e realizuar ndër-vite të kostos fikse dhe variable me OShP-në;
6. Kompensimi i llogarisë të tarifës administrative nga llogaritë e NSh-ve përkatëse në vlerën prej **EUR 132,012**; Këto mjete janë kompensuar nga pagesat e realizuar për shpenzimet e NSh-ve të cilat nuk kanë pasur mjeteve për ekzekutim të pagesave;
7. Të hyrat e realizuara transferuara për tarifën administrative prej **EUR 3,018,474** nga **5% i tarifës administrative, konfiskimi i BID depozitave si dhe tarifa për pjesëmarrje në tenderë**;
8. Transferimin e shumave të pa shpërndara si pjesë e 20% për në llogarinë në mirëbesim për punëtorët e NSh-ve. **Gjatë periudhës raportuese**, gjithsej shuma e transferuar për punëtorët në llogari që mbahet në mirëbesim nga AKP është **EUR 421,536**. Këto mjete do të shpërndahen pas shqyrtimit të ankesave nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme.

LLOGARITË BANKARE TË TJERA NË BANKAT KOMERCIALE

AKP-ja gjatë vitit fiskal 2017 ka mbyllur llogaritë bankare që ka pasur në Procredit Bank duke i transferuar mjetet në llogari të NSh-ve përkatëse prej EUR 295.70 si dhe duke transferuar të drejtën e nënshkrimit në llogarinë që ka pasur gjendjen prej EUR 1,250 për shitjen e Ndërmarrjen e Re. Kjo ka qenë paguar si kapital themeltar për NSh kur është themeluar.

Është vetëm një llogari bankare në të cilën ka mjete bankare që AKP-ja mbanë në Procredit Bank:

1. Garancioni bankar për MIM Golesh në shumën prej EUR 64,466.50 për liçensën sipas rregullorës të Komisionit për Miniera dhe Minerale të Kosovës.

GJENDJA E PROCESIT TË LIKUIDIMIT TË NSh-ve NË LIKUIDIM

PERIUDHA 2005 - 2017

NR.	LLOJI I TË ARDHURAVE	PËRSHKRIMI I SHPENZIMEVE	VLERA
1	Shitje e aseteve	i1 - Shitje gjatë likuidimit	109,132,596
2	Shitje e aseteve	i3 - Depozita të transferuara nga llogaria e depozitës së tenderëve	9,361,270
3	Shitje e aseteve	i1a - Shitjet e banesave	245,994
4	Qiraja	i12 - Të ardhura nga qiraja	15,637,635
5	Interesi	i2 - Interesi i fituar	8,388,625
6	Të ardhura tjera	i4 - TVSH hyrëse	532,714
7	Të ardhura tjera	i8 - Transferimi i depozitave të parave të gatshme	23,029
8	Të ardhura tjera	i13 - Të ardhura tjera	570,697
9	Të ardhura tjera	i9 - Transferim nga llogaritë bankare të NSh-ve	668,091
10	Të ardhura tjera	i10 - Pranimet nga debitorët e NSh-ve	33,354
11	Nga shitja të Nder. Reja	i6 - Transferimi i 75% nga shitjet me privatizim	443,471,431
12	Nga shitja të Nder. Reja	i7 - Transferimi i parave të NSh-ve në mirëbesim	10,834,894
GJITHSEJ TË HYRAT NË LLOGARITË BANKARE TË NSh-vë NË LIKUIDIM			598,900,330

NR	SIPAS LIGJIT NR. 04/L-034	PËRSHKRIMI I SHPENZIMEVE	VLERA
1	Rreg. për punëtorët	Mjetet që u takojnë punëtorëve (20%) nga shitjet me likuidim	18,432,392
2	neni 21 i AKP-së i Ligjit nr. 04/L-034	Tarifa administrative e Agjencisë (5% e shitjeve të likuidimit dhe interesit në llogaritë bankare)	6,103,122
3	40.1.1	Kostot e Shitjes ose Përndryshe Realizimi i pronës ose aseteve si dhe shpenzimet e likuidimit	1,129,391
4	40.1.3.1	Shpenzimet Gjyqësore	100,509
5	40.1.3.2	Shpenzimet e Administratorit, Autoritetit të Likuidimit dhe Këshilltarëve tjerë	15,327,728
6	40.1.3.3	Shpenzimet për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e pronës dhe aseteve	2,105,795
7	40.1.3.4	Shpenzimet për vazhdimin e operacioneve të Ndërmarrjes	5,986,043
8	40.1.3.4	Shpenzimet të likuidimit: Pagesa e tatimeve (Tatimi i të Ardhurave Personale, Tatimi i Pronës, TVSH etj.)	2,839,445
9	40.1.4	Kreditorët e siguruar për ato raste që janë realizuar nga sigurimi i atyre aseteve	48,652
10	40.1.6.1	Kreditorët e pagave për 3 muaj pagat bruto dhe pensioni	2,169,454
11	40.1.6.2	Kreditorët: pagesat për pushim nga puna të papaguara në fillim të Likuidimit	3,298,332
12	40.1.7	Kreditorët e pasiguruar	17,935,165
13	40.1.8	Kreditorët - Pronarët, aksionarët, themeluesit, pjesëmarrësit ose partnerët në NSh	526,281
14	19.3.3, 40 dhe 42	Fondet Tepricë dhe Fondet e Mbetura transferuar Qeverisë	90,570,575
GJITHSEJ PAGESAT NGA LLOGARITË BANKARE TË NSh-ve NË LIKUIDIM			166,572,884

*Detajet e shpenzimeve të kategorizuar sipas renditjes së mësipërme janë në faqen tjetër

GJENDJA E LLOGARISË BANKARE TË NSh-ve NË LIKUIDIM 432,327,446

PLANI KONTABËL PËR SHPENZIMET E NSH-VE NË LIKUIDIM

Lista detaje e shpenzimeve sipas renditjes të tabelës

RENDITJA	PËRSHKRIMI	VLERA
1	e2 - Transferim tek punëtorët (BSPK)	12,733,713
	e3 - Transferim tek llogaritë në mirëbesim për punëtorët	5,698,679
2	e4 - Tarifa administrative e agjencisë (5% e shitjeve me likuidim)	5,731,139
	e4a - Tarifa Administrative e Agjencisë (5% e interesit në llogarinë bankare të likuidimit)	371,982
3	e1 - Shpenzimet bankare	21,420
	e6 - Shpenzime për reklamim	708,414
	e7 - Kostoja e shitjes për likuidim të aseteve	45,320
	e8 - Gjëra për zyrë, shpenzime të vogla zyre dhe posta	272,720
	e9 - Magazinim, transportim i dokumenteve të NSH-ve	7,558
	e10 - Para të imta AVANS për kosto të vogla për likuidim	421
4	e11 - Shpenzimet e imta të MBYLLURA - Shpenzime aktuale për kosto të vogla likuidimi	73,537
	e14 - Shpenzime për gjykatë	100,509
5	e16 - Ofrues Profesional të Shërbimeve (Autoriteti i Likuidimit)	15,327,728
6	e21 - Shërbime për mirëmbajtje të aseteve	11,917
	e22 - Shërbime për mbrojtje të pronës dhe aseteve	2,093,878
7	e17 - Ofrues të shërbimeve (pagesa bruto)	1,504,097
	e18 - Ofrues të shërbimeve (pagesa neto)	2,182,411
	Pagesa në avans për udhëtime zyrtare	625
	e25 - Qiraja e paguar (bruto)	123,120
	e26 - Qiraja e paguar (neto pas tatimit mbi qiranë)	35,736
	e20 - Shërbime profesionale	173,320
	e27 - Mallra	133,574
	e29 - Shërbime	439,945
	e30 - Ujë	131,282
	e31 - Rrymë	945,301
	e32 - Mbeturina	259,258
	e33 - Telekomunikacion (Internet, telefon)	25,613
8	e24 - Udhëtime zyrtare	31,760
	e19 - Tatimi në të ardhura personale për Ofrues të Shërbimeve	358,898
	e34 - Tatimi që mbahet mbi qiranë e paguar	2,995
	e35 - Tatimi i paguar për qiranë e pranuar	85,276
	e36 - Tatimi komunal në pronë	599,839
	e38 - Tatimi i korporatës	214,922

9	e39 - TVSH paguar ATK-së	1,577,515
	e41 - Kreditorë të siguar	48,652
10	e43 - Pagat (neto) kreditorë preferencialë 3 paga	1,902,099
	e44 - Tatimi në ardhurat personale (kreditorë preferencialë 3 paga)	56,878
	e45 - Kontribute për pension (për kreditorë preferencialë 3 paga)	210,477
11	e46 - Pagesa për ndërprerje të punësimit (neto) kreditorë preferencialë	2,860,533
	e47 - Tatimi në të ardhura personale (pagesa për ndërprerje të punës kreditorë preferencialë)	118,068
	e48 - Kontributi për pension (për pagesë të ndërprerjes së punës për kreditorë preferencialë)	319,731
	e49 - Pagat (neto) kreditorë të pasiguar	5,758,310
12	e50 - Tatimi në të ardhura personale (pagat e kreditorëve të pasiguar)	771,555
	e51 - Kontribute për pension kreditorë të pasiguar	1,750,868
	e52 - Kreditorët e pasiguar - Huazimet	135,755
	e53 - Avanset e pranuar në para të gatshme nga NSH-të - kreditorë të pasiguar	200,586
	e54 - Furnizues vendorë kreditorë të pasiguar	2,460,423
	e55 - Furnizues ndërkombëtarë kreditorë të pasiguar	204
	e56 - Tatimi në pronë - kreditorë të pasiguar	1,285,347
	e57 - Tatimi mbi qiranë kreditorë të pasiguar	58,554
	e58 - Tatimi i korporatës kreditorë të pasiguar	475,082
	e59 - TVSH kreditorë të pasiguar	3,193,597
	e60 - Tatimi i paragjykuar kreditorë të pasiguar	167,935
	e61 - Rryma kreditorë të pasiguar	493,379
13	e62 - Ujë kreditorë të pasiguar	194,763
	e63 - Mbeturina kreditorë të pasiguar	159,787
	e64 - Telekomunikim dhe Internet kreditorë të pasiguar	31,023
	e65 - Kreditorë tjerë të pasiguar	797,997
14	e66 - Kërkesa të pronarëve, aksionarëve, themeluesve, pjesëmarrësve, partnerëve në NSH	526,281
	e0 - Fondet Tepricë për Qeverinë e Kosovës - neni 19.3.3 i Ligjit të AKP-së	90,244,911
	e67 - Fondet e mbetura për Qeverinë e Kosovës	325,664

LLOJET E LLOGARIVE BANKARE

1. **LLOGARITË E PRIVATIZIMIT** - Përdoren për të mbajtur të ardhurat e privatizimit/shitjes sipas nenit 8 deri në nënshkrimin e kontratave të shitjes. Pas nënshkrimit të kontratave të shitjes, bëhen këto veprime: pagesat për 20%-in e punëtorëve; transferimi i tarifës administrative (5% e shitjes) në llogarinë e dedikuar të Agjencisë për të ardhurat nga tarifa administrative. Prej kësaj llogarie transferohen tarifat në llogarinë bankare sipas nenit 64 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; dhe 75% e çmimit të shitjes transferohen në llogarinë e likuidimit.
2. **LLOGARITË E NSH-ve NË TRANZICION** - Mban paratë e NSH-ve në mirëbesim në rastet kur Agjencia vendos që NSH-ja nuk ka resurse për të mbajtur këto para ose kur rrethanat nuk e lejojnë për të vepruar ndryshe për shkak të specifikave të NSH-ve (rasti i statuseve të pa përcaktuara të NSH-ve e të ngjashme).
3. **LLOGARITË E LIKUIDIMIT** - Përdoren për NSH-të pasi që kanë hyrë në likuidim. Të gjitha llogaritë bankare e NSH-ve mbyllen dhe gjendja e tyre bankare transferohet në këto llogari.
4. **LLOGARITË E KOMERCIALIZIMIT** - Mban shumat e qirave të mbledhura gjatë procesit të komercializimit të NSH-ve, pra të kontratave të nënshkruara para privatizimit të NSH-ve dhe ato kontrata të koncesionit ose dhënies me qira që nënshkruhen pas themelimit të Agjencia Kosovare të Privatizimit. Pas përfundimit të kontratës së komercializimit bëhen këto veprime: transferimi i tarifës administrative (5% e qirave të paguara gjatë komercializimit) në llogarinë e dedikuar të Agjencisë për të ardhurat nga tarifa administrative. Prej kësaj llogarie transferohen tarifat në llogarinë bankare sipas nenit 64 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; dhe 95% e të ardhurave nga komercializimi transferohen në llogarinë e likuidimit, nëse nuk parashihet ndryshe.
5. **LLOGARITË E PARAVE NË MIRËBESIM PËR PUNËTORËT** - Mban paratë në mirëbesim në emër të punëtorëve që janë transferuar nga llogaritë e privatizimit dhe likuidimit. Këto para janë pjesa e mbetur e 20%-it që iu takon punëtorëve në rastet kur më parë është bërë shpërndarja e parakohshme e 20% e të ardhurave nga shitjet sipas nenit 8 dhe 20% e të ardhurave nga shitja sipas nenit 9 të ligjit të Agjencisë.
6. **DEPOZITAT NGA TENDERËT E PRIVATIZIMIT** - Përdoren për mbajtjen e depozitave të paguara nga ofertuesit gjatë procesit të ofertimit për shitjet sipas nenit 8 të ligjit mbi AKP-në. Kjo është një llogari e përkohshme prej ku Agjencia ia kthen depozitin e ofertës ofertuesit jo fitues (të pasuksesshëm). Depoziti i ofertuesit të suksesshëm transferohet në llogarinë e mirëbesimit të hapur në veçanti për Ndërmarrjen e Re që shitet.

7. **TARIFAT PËR TENDERËT E PRIVATIZIMIT** - Përdoret për mbajtjen e tarifës së pakthyeshme për dorëzimin e ofertës nga ofertuesit gjatë procesit të ofertimit për shitjet sipas nenit 8 të ligjit. Këto para llogariten si të ardhura të dedikuara të Agjencisë.
8. **DEPOZITAT NGA TENDERËT E LIKUIDIMIT** - Përdoret për shitjet sipas nenit 9 për mbajtjen e depozitave të paguar nga ofertuesit gjatë procesit të ofertimit për shitjen e pasurive të NSH-ve që janë në likuidim. Kjo është një llogari bankare e përkohshme prej ku Agjencia ia kthen depozitin ofertuesit të pasuksesshëm. Depoziti i ofertuesit të suksesshëm transferohet në llogarinë e mirëbesimit të hapur në veçanti për NSH në likuidim.
9. **TARIFAT PËR TENDERËT E LIKUIDIMIT** - Përdoret për mbajtjen e tarifës së pakthyeshme për dorëzimin e ofertës nga ofertuesit gjatë procesit të ofertimit për shitjet sipas nenit 9 të ligjit. Këto para llogariten si të ardhura të dedikuara të Agjencisë.
10. **DEPOZITAT E KOMISIONIT TË RISHIKIMIT TË LIKUIDIMIT** - Ka mbajtur depozitat e paguara nga parashtuesit për ankesat në procesin e likuidimit të dorëzuara në ish-Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave. Pas kthimit të depozitave siç parashihet në nenin 24.4 të ligjit të Agjencisë, kjo llogari do të mbyllet.
11. **LLOGARIA E KAPITALIT THEMELTAR** - Mban pagesën në kapital nga Buxheti i Kosovës mbi themelimin e Agjencisë
12. **LLOGARIA E FONDIT REZERVË TË AKP-SË** - Para se të hyjë në fuqi ligji i ri për 5% e tarifës administrative është mbajtur për të përdorur të ardhurat vetanake të AKP-së për depozitat e konfiskuara nga shitjet e privatizimit, likuidimit, transferimin e tarifave për shitjet përmes privatizimit dhe likuidimit, interesin e fituar në llogaritë e depozitave dhe tarifave për pjesëmarrjen në tenderët e shitjes përmes privatizimit apo likuidimit.
13. **LLOGARIA E DONATORIT** - Mban paratë e donatorëve në rastet kur donatorët kërkojnë që paratë e tyre të kanalizohen përmes llogarive bankare të Agjencisë.
14. **LLOGARIA E TARIFËS ADMINISTRATIVE** - Në këtë llogari transferohet tarifa administrative e Agjencisë. Në periudha të ndryshme, Agjencia transferon gjendjen në këtë llogari bankare në llogarinë e specifikuar nga Ministria e Financave për të mbajtur të ardhurat e dedikuara nga tarifat administrative të Agjencisë.
15. **LLOGARIA E DEPOZITAVE KOHOR** - Janë llogaritë bankare të depozitave kohor në të cilat transferohet mjetet për afatizim për periudha të ndryshme (deri në një vjet). Nëse ka norma të interesit pozitive që oferton BQK-ja, atëherë sipas marrëveshjes AKP afatizon këto mjete në Bankën Qendrore të Kosovës.